

Të dashur bashkëqytetarët e mi,

Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2020 – 2022 që prezantojmë sotmbështet vizionin tonë për përmirësimin e cilësisë së jetës, përmirësimin e aksesit, integrimin territorial dhe barazinë në shërbime, zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe mbrotjen e mjedisit, me synim për ta kthyer Shkodrën në një qendër të përparuar social – ekonomike.

Ky dokument prezanton një qasje gjithëpërfshirëse ndaj realizimit efektiv të politikave zhvillimore të Bashkisë Shkodër në përputhje me informacionin financiar për të ardhurat dhe shpenzimet. Vlen të theksohet se objektivat e strategjisë së zhvillimit kanë shërbyer si bazë për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm duke realizuar kështu një lidhje integrale të objektivave dhe planit të veprimit të strategjisë së zhvillimit, me projektet e parashikuara në secilin program buxhetore të Bashkisë Shkodër. Mbi bazën e këtij parimi është ndërtuar kuadri logjik i PBA-së dhe është bërë ndarja e burimeve të disponueshme për secilin program buxhetor. Duke bërë këtë kemi siguruar një sistem menaxhimi efikas, të përgjegjshëm dhe transparent për përdorimin e fondeve publike, kjo jo vetëm si një detyrim ligjor por edhe si një praktikë e mirë e Bashkisë Shkodër në ngritjen e një sistemi efektiv për menaxhimin financiar të fondeve publike.

Prezantimi i PBA-së si një instrument i rëndësishëm financiar, ku objektivat e strategjisë së zhvillimit përkthehen në ndërhyrje konkrete, vjen pas një procesi të gjatë pune. Ky proces ka ecur paralelisht me harmonizimin e dokumentave strategjike që Bashkia Shkodër disponon si dhe me organizimin e një sërë takimesh konsultative me aktorë dhe palë të interesuara për të adresuar nevojat konkrete të tyre. Sa më sipër është miratuar kalendari i hartimit të Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) dhe është përcaktuar veprimtaria e punës së Ekipeve të Menaxhimit të Programit (EMP). Këto ekipe teknike janë angazhuar në organizimin e një sërë takimesh konsultative në të gjitha njësitë administrative të Bashkisë Shkodër. Pjesë e pa ndarë e këtij procesi kanë qenë edhe konsultimet e tjera publike të cilat Bashkia ka ndërmarrë gjatë zhvillimit të aktiviteteve të saj.

Synimi jonë është është kthimi i Bashkisë Shkodër në një qendër të rëndësishme kombëtare, një portë e Shqipërisë në Ballkanin Perëndimor dhe një nyje e rëndësishme transporti. Në përmbushje të këtij synimi Bashkia Shkodër do të fokusojë përpjekjet e saj në drejtim të garantimit të barazisë në shërbime dhe në akses ndaj qytetarëve dhe vizitorëve bazuar në një sistem policentrik të zhvillimit. Për këtë arsye programi buxhetor afatmesëm do t'i shërbejë përpjekjeve në vazhdim për të përmbushur vizionin e Strategjisë Territoriale për Zhvillim 2015 – 2030 si më poshtë vijon:

- Përmirësimin dhe modernizimin e infrastrukturës rrugore urbane dhe rurale duke mundësuar akses të plotë për të gjithë, përmes financimit me fondet e veta, në fondet ndërkombëtare dhe të donatorëve, aksesit në fondet qeveritare;*

- *Përmirësimin e menaxhimit të shërbimeve publike: menaxhimit të mbetjeve, mbrojtjes së mjedisit, ndriçimit rrugor, furnizimit me ujë të pijshëm, hapësirve të gjelbra, etj.;*
- *Përmirësimin e levizshmërisë urbane për një siguri dhe cilësi jetese më të mirë;*
- *Përmirësimin e infrastrukturës turistike dhe promovimin e territorit të Bashkisë Shkodër;*
- *Promovimin e produkteve vendore, nxitjen e shumëllojshmërisë së veprimtarive bujqësore dhe ekonomike në zonat rurale në nivelin e fermës dhe të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.*
- *Mbrojtjen e mjedisit, parandalimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të qytetareve;*
- *Projektimin, përmirësimin e kushteve të qendrave shëndetësore parësore në territor dhe mire administrimin e infrastrukturës së ndërtuar;*
- *Nxitjen e pjesëmarrjes së të rinjve në aktivitete sportive si aktorë thelbësorë në zhvillimin e territorit;*
- *Ruajtjen dhe promovimin i trashëgimisë kulturore të zonave të ndryshme të Bashkisë Shkodër;*
- *Sigurimin e ambjenteve dhe mjediseve të përshtatshme arsimore, të sigurta dhe drejt përmbushjes së standarteve ligjore;*
- *Krijimin e mundësive të barabarta dhe mosdiskriminim për shkak të aftësive ndryshe, gjinisë, moshës, origjinës, minoritetit;*
- *Parandalimin e kundërvajtjeve administrative, forcimin, inspektimin dhe monitorimin e zbatimit të rregulloreve e të akteve të bashkisë dhe këshillit bashkiak.*

Transparenca, llogaridhënia, lufta kundër korrupsionit, qeverisja me pjesëmarrje, shërbesa me etikë dhe përgjegjshmëri, ndërhyrjet me efikasitet, përdorimi me efikasitet të fondeve, Instrumentet e rinj të administrimit, përmes përdorimit të teknologjisë bashkohore, procedurave dhe rregullave që do të vijojmë të zhvillojmë, janë principet dhe mënyra e punës tonë.

Nëpërmjet këtij dokumenti synojmë të informojmë çdo banor kudo, publikun e gjerë, qeverinë dhe partnerët, lidhur me parashikimet afatmesme të shpenzimeve të Bashkisë Shkodër.

Besoj që të gjithë bashkë, me shumë punë e përkushtim, do të vazhdojmë të përmbushim përgjegjësitë për të administruar, shërbyer dhe zhvilluar Shkodrën.

Unë besoj në kontributin dhe mbështetjen tuaj!

Voltana Ademi

KRYETARE



BASHKIA SHKODER

PBA

2020 – 2022

Tabela e Përmbajtjes

Vështrim i përgjithshëm	
Parashikimi i të ardhurave	
Shpenzimet buxhetore 2017 – 2022	
Projektet e investimeve	
Treguesit kyç financiar	
Sektorët Strategjikë	
Programi Buxhetor: 01110 – Planifikim, Menaxhim dhe Administrim	
Programi Buxhetor: 01170 – Gjendja Civile	
Programi Buxhetor: 03140 – Shërbimet e Policisë Vendore	
Programi Buxhetor: 03280 – Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	
Programi Buxhetor: 04130 – Mbështetja për zhvillimin ekonomik	
Programi Buxhetor: 04130 – Shërbimi i tregjeve, akreditimi dhe inspektimi	
Programi Buxhetor: 04220 – Shërbimet bujqësore , inspektimi, ushqimi dhe mbrojtja e konsumatorëve	
Programi Buxhetor: 04240 – Menaxhimi i Infrastruktues së ujitjes dhe kullimit	
Programi Buxhetor: 04260 – Administrimi i pyjeve dhe kullotave	
Programi Buxhetor: 04520 – Rrjeti rrugor rural	
Programi Buxhetor: 04570 – Transporti publik	
Programi Buxhetor: 04760 – Zhvillimi i turizmit	
Programi Buxhetor: 05100 – Menaxhimi i mbetjeve	
Programi Buxhetor: 05200 – Menaxhimi i ujërave të zeza dhe kanalizime	
Programi Buxhetor: 05320 – Programet e mbrojtjes së mjedisit	
Programi Buxhetor: 05630 – Ndërgjegjësimi mjedisor	
Programi Buxhetor: 06140 – Planifikimi Urban Vendor	
Programi Buxhetor: 06260 – Shërbime publike vendore	
Programi Buxhetor: 06330 – Furnizimi me ujë	
Programi Buxhetor: 06440 – Ndriçim rrugësh	
Programi Buxhetor: 07220 – Shërbimet e kujdesit parësor	

<i>Programi Buxhetor: 08130 – Sport dhe argëtim</i>	
<i>Programi Buxhetor: 08220 – Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore</i>	
<i>Programi Buxhetor: 09120 – Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor</i>	
<i>Programi Buxhetor: 09230 – Arsimi i mesëm i përgjithshëm</i>	
<i>Programi Buxhetor: 09240 – Arsimi profesional</i>	
<i>Programi Buxhetor: 10140 – Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara</i>	
<i>Programi Buxhetor: 10220 – Sigurimi shoqëror</i>	
<i>Programi Buxhetor: 10430 – Kujdesi social për familjet dhe fëmijët</i>	
<i>Programi Buxhetor: 10661 – Strehimi social</i>	



MISIONI I BASHKISË SHKODËR

Bashkia Shkodër ka për mision hartimin dhe zbatimin e strategjive dhe politikave, ushtrimin efektiv të funksioneve dhe kompetencave, ofrimin dhe realizimin e shërbimeve bazuar në nevojat e komunitetit në përputhje me kuadrin ligjor në Republikën e Shqipërisë.

ORIENTIMI AFATGJATË

Bashkia Shkodër në 2030 do të jetë një qendër e rëndësishme kombëtare, një portë e Shqipërisë në Ballkanin Perëndimor dhe një nyje e rëndësishme transporti. Bashkia Shkodër është lider i rajonit ekonomik Shkodër-Lezhë-Podgoricë dhe ndërvepron me sukses si pjesë e nënrajoneve natyrore, ndërkufitare e turistike.

Një bashki me një zhvillim territorial të integruar e cila garanton barazinë në shërbime dhe në akses ndaj qytetarëve dhe vizitorëve bazuar në një sistem policentrik të zhvillimit. Një qendër primare me një cilësi të lartë jetese ku ballinat ujore dhe zonat historike gjallërojnë jetën urbane të Bashkisë Shkodër. Shkodra si një model ndërkombëtar për zhvillimin e pedalimit bazuar në kulturën qytetare të përdorimit të hapësirës së përbashkët dhe kombinimit të modaliteteve të ndryshme të transportit.

Zhvillimi Ekonomik dhe Urban ndërthuret me mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, historike e natyrore. Turizmi gjithëvjetor do të jetë një vlerë e shtuar në ekonominë vendore e kombëtare duke garantuar larmishmëri në zhvillim me anë të ekoturizmit, agro-turizmit, turizmit kulturor, malor e ujqor. Një Bashki e cila promovon dhe mbështet sipërmarrjet e reja duke tërhequr talentin vendas e rajonal.

Shkodra me një mjedis të pastër e cilësor si një bashki e aftë të përballojë presionet dhe krizat e ndryshme ekonomike, sociale e natyrore duke garantuar një cilësi të lartë jetese e zhvillimi. Shkodra bashkëjeton në harmoni me ujin dhe përballet me sukses me rrezikun e përmytjeve.

PLANIFIKIMI BUXHETOR AFATMESËM 2020 – 2022

Parashikimi buxhetor afatmesëm është hartuar bazuar në:

- Përmirësimin e Aksesit dhe Marrëdhënieve Rajonale
- Integrimin Territorial dhe Barazinë në Shërbime e Akses
- Konkurrueshmërinë dhe Zhvillimin Ekonomik
- Cilësinë e Lartë e Jetesës dhe Zhvillimin Urban
- Mbrojtjen e mjedisit dhe aftësinë për tu përshtatur, mbrojtur dhe rimëkëmbur nga rreziqet natyrore

Shpërndarja e financimeve 2020 - 2022

- Shpërndarje e burimeve financiare për periudhën 2020-2022 sipas çdo programi
- Shpenzime bazuar në politikat dhe objektivat e programeve sipas funksioneve të veta, të deleguara dhe atyre të financuara me transfertë të pakushtëzuar sektoriale
- Shpenzime personeli për administratën e bashkisë dhe gjithë punonjësit e njësisë të varësisë.

Programi buxhetor afatmesëm synon

- Prioritet për investime të miratuara në PPV dhe të konsultuara, në fushen e infrastruktures publike;
- Vlerësimin e projekteve dhe lidhjen e tyre me programet e shpenzimeve publike
- Qasje të reja në fusha të ndryshme si administratë, investime, procese politike dhe jetë publike që përkthehet në implementim konkret të objektivave të barazisë gjinore në nivel qeverie vendore

Parashikimi i të ardhurave është bazuar në:


- administrimin dhe dhënien e shërbimeve ndaj qytetarëve në gjithë territorin e saj, si një mekanizëm kyç për mbledhjen e detyrimeve vendore të bizneseve dhe individëve
- shfrytëzimi dhe vënia në efikasitet të aseteve të veta
- implementimi i procedurave online e të thjeshta, politikat lehtësuese, taksa të ulta dhe rritja e frymës së konkurrencës së ndershme, thjeshtimi dhe standartizimi i procedurave, si dhe trajtimit të qytetarëve dhe bizneseve si partnerë të përbashkët të bashkisë.

Në mënyrë të përmblodhur kjo paketë fiskale synon:


- Përditësimin dhe aplikimin e kornizës ligjore të ndryshuar;
- Përditësimin e procedurave, afateve, aktorëve, veprimeve, përgjegjësisë për vjeljen e çdo takse dhe tarife, pjesë e kësaj pakete fiskale.
- Përmirësimin e sistemit fiskal eficient dhe transparent;
- Përcaktimine qartë në seksione të taksave dhe tarifave.
- Synojmë në një
 - Taksim të drejtë;
 - Tarifim të mbështetur në kosto shërbimi;
 - Klasifikim i biznesit sipas qarkullimit vjetor, llojit të aktivitetit, vendodhjes, etj.
- Aplikimi i incentivave, lehtësirave fiskale, përjashtimeve për grupe të caktuara taksapaguesish në nevojë, për aq sa lejon dhe lejon ligji.

Të ardhurat sipas burimeve buxhetore 2017 – 2022


Burimi buxhetor	Fakt 2017	Fakt 2018	I Pritshmi 2019	Plan 2020	Plan 2021	Plan 2022
Të ardhura nga burimet e veta	624,684	745,034	700,654	817,379	822,317	837,657
Të ardhura nga taksat lokale	278,096	280,071	313,463	397,063	399,818	402,585
Të ardhura nga taksat e ndara	57,207	81,214	74,560	89,735	92,439	95,144
Të ardhura nga tarifa vendore	241,838	305,624	287,428	312,635	315,187	324,817
Të ardhurat e tjera	47,543	78,125	25,203	17,947	14,873	15,112
Të ardhura nga buxheti qendror	1,946,673	1,928,213	1,933,864	2,077,343	2,095,654	2,180,290
Transferta e pakushtëzuar	555,124	606,231	630,668	648,181	726,624	772,600
Transferta e kushtëzuar	1,077,963	970,505	946,885	1,055,969	995,837	1,015,837
Trasferta specifike	313,586	351,477	356,311	373,193	373,193	391,853
Trashëgimi nga viti i shkuar	489,707	342,615	1,035,187	74,596	-	-
Trashëgimi pa destinacion	489,707	310,751	982,596	1,047	-	-
Trashëgimi me destinacion	-	31,864	52,591	73,549	-	-
TOTALI	3,061,064	3,015,862	3,669,705	2,969,318	2,917,971	3,017,947




Të ardhurat sipas burimeve buxhetore 2017 – 2022




- Të ardhura nga burimet e veta
- Të ardhura nga buxheti qendror
- Trashëgimi nga viti i shkuar




- Të ardhura nga burimet e veta
- Të ardhura nga buxheti qendror
- Trashëgimi nga viti i shkuar




- Të ardhura nga burimet e veta
- Të ardhura nga buxheti qendror
- Trashëgimi nga viti i shkuar



- Të ardhura nga burimet e veta
- Të ardhura nga buxheti qendror
- Trashëgimi nga viti i shkuar



- Të ardhura nga burimet e veta
- Të ardhura nga buxheti qendror
- Trashëgimi nga viti i shkuar



- Të ardhura nga burimet e veta
- Të ardhura nga buxheti qendror
- Trashëgimi nga viti i shkuar


Shpenzimet buxhetore 2017 – 2022

Shpenzimet buxhetore sipas programeve buxhetore 2017 – 2022

në 000/lekë

Kodi	Programi buxhetor	Fakt 2017	Fakt 2018	I Pritshmi 2019	Plan 2020	Plan 2021	Plan 2022
1110	Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi	258,521	265,560	391,873	273,363	283,045	292,225
1110	Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi	258,521	265,560	327,170	282,462	283,045	292,225
1170	Gjendja civile	31,183	18,102	22,546	14,920	14,920	14,920
3140	Shërbimet e Policisë Vendore	13,788	15,975	27,864	20,418	20,997	21,373
3280	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	44,287	47,680	66,234	106,380	47,758	49,480
4130	Mbështetja e Zhvillimit Ekonomik	2,333	8,544	9793	6,915	8,022	8,322
4160	Shërbimet e tregjeve, akreditimi dhe inspektimi	0	11,571	2,708	1,500	20,500	26,000
4220	Shërbimet bujqësore, inspektimi, ushqimi dhe mbrojtja e konsumatoreve	1,100	580	3,108	2,444	2,444	2,444
4240	Menaxhimi i Infrastruktues së ujitjes dhe kullimit	65,913	59,216	83,161	33,364	33,364	35,546
4260	Administrimi i pyjeve dhe kullotave	11,168	11,342	28,603	20,888	20,888	21,405
4520	Rrjeti rrugor rural	187,199	203,788	667,297	330,022	342,842	353,575
4570	Transporti publik	12,293	9,549	18,459	13,494	13,620	13,620
4760	Zhvillimi i turizmit	3,865	5,042	8,107	6,810	8,410	6,350
5100	Menaxhimi i mbetjeve	132,574	190,374	239,888	205,000	209,484	209,484
5200	Menaxhimi i ujrave të zeza dhe kanalizimeve	7,911	7,262	22,738	12,000	15,000	15,000
6140	Planifikimi Urban Vendor	0	0	6,396	2,168	2,189	2,189
6260	Shërbime publike vendore	59,446	75,098	112,250	83,335	85,472	86,102
6330	Furnizimi me ujë	189	0	102,504	500	500	500
6440	Ndriçim rrugësh	81,754	99,553	106,464	97,761	98,380	109,676
7220	Shërbimet e kujdesit parësor			1,500	3,000	-	-
8130	Sport dhe argëtim	94,863	122,500	153,319	115,042	102,734	102,834
8220	Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore	71,078	75,262	109,075	87,665	89,895	91,036
9120	Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor	218,755	232,721	314,449	283,697	302,022	313,272


9230	Arsimi i mesëm i përgjithshëm	86,408	100,590	85984	54,064	46,123	69,041
9240	Arsimi Profesional	25,351	34,831	82883	61,758	61,758	64,652
10140	Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara	18,064	17,094	24689	36,633	36,637	38,445
10430	Kujdesi social për familjet dhe fëmijët	974,652	989,919	931270	1,010,403	1,026,510	1,046,744
10661	Strehimi social	0	7,933	37026	45,026	1,754	1,750
	Fond rezerve dhe kontigjence				31,649	22,703	21,962
TOTALI		2,402,695	2,610,086	3,595,485	2,969,318	2,917,971	3,017,947



në 000/lekë

Shpenzimet buxhetore sipas klasifikimi ekonomik 2017 – 2022


Shpenzimet	Fakt 2017	Fakt 2018	I Pritshmi 2019	Plan 2020	Plan 2021	Plan 2022
Shpenzimet korrente	2,092,535	2,261,546	2,610,440	2,537,656	2,487,592	2,540,552
Investimet	310,160	348,540	985,045	431,662	430,379	477,395
Totali	2,402,695	2,610,086	3,595,485	2,969,318	2,917,971	3,017,947




Shpenzimet buxhetore sipas programeve buxhetore 2020 – 2022 kundrejt totalit

Kodi	Programi buxhetor	Raporti kundrejt totalit 2020	Raporti kundrejt totalit 2021	Raporti kundrejt totalit 2022
10430	Kujdesi social për familjet dhe fëmijët	34.4%	35.2%	34.7%
4520	Rrjeti rrugor rural	11.2%	11.7%	11.7%
9120	Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor	9.7%	10.4%	10.4%
1110	Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi	9.6%	9.7%	9.7%
5100	Menaxhimi i mbetjeve	7.0%	7.2%	6.9%
8130	Sport dhe argëtim	3.9%	3.5%	3.4%
6440	Ndriçim rrugësh	3.3%	3.4%	3.6%
8220	Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore	3.0%	3.1%	3.0%
6260	Shërbime publike vendore	2.8%	2.9%	2.9%
9240	Arsimi Profesional	2.1%	2.1%	2.1%
9230	Arsimi i mesëm i përgjithshëm	1.8%	1.6%	2.3%
3280	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	1.6%	1.6%	1.6%
10661	Strehimi social	1.5%	0.1%	0.1%
10140	Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara	1.2%	1.3%	1.3%
4240	Menaxhimi i Infrastruktues së ujitjes dhe kullimit	1.1%	1.1%	1.2%
4260	Administrimi i pyjeve dhe kullotave	0.7%	0.7%	0.7%
3140	Shërbimet e Policisë Vendore	0.7%	0.7%	0.7%
1170	Gjendja civile	0.5%	0.5%	0.5%
4570	Transporti publik	0.5%	0.5%	0.5%
5200	Menaxhimi i ujrave të zeza dhe kanalizimeve	0.4%	0.5%	0.5%
4130	Mbështetja e Zhvillimit Ekonomik	0.2%	0.3%	0.3%
4760	Zhvillimi i turizmit	0.2%	0.3%	0.2%
7220	Shërbimet e kujdesit parësor	0.1%		
4220	Shërbimet bujqësore, inspektimi, ushqimi dhe mbrojtja e konsumatoreve	0.1%	0.1%	0.1%
6140	Planifikimi Urban Vendor	0.1%	0.1%	0.1%
4160	Shërbimet e tregjeve, akreditimi dhe inspektimi	0.1%	0.7%	0.9%


Shpenzimet buxhetore sipas klasifikimi ekonomik 2017 – 2022




■ Shpenzimet korrente ■ Investimet




■ Shpenzimet korrente ■ Investimet




■ Shpenzimet korrente ■ Investimet



■ Shpenzimet korrente ■ Investimet



■ Shpenzimet korrente ■ Investimet



■ Shpenzimet korrente ■ Investimet

Investimet kapitale

Shpenzimet kapitale në vitin 2021 ruajnë pothuajse të një nivel në raport me 2020, ndërsa në vitin 2022 janë rritur **11%** në raport me 2021.

Shpenzimet korrente

Shpenzimet korrente në vitin 2020 janë zbritur me **4.1%** në raport me 2019, shpenzimet korrente në vitin 2021 janë zbritur me **0.7%** në raport me 2020 ndërsa në vitin 2022 janë rritur **2.1%** në raport me 2021.

Shpenzimet e personelit

Shpenzimet për paga në vitin 2021 janë rritur me **1%** në raport me 2020 ndërsa në vitin 2022 janë rritur **1%** në raport me 2021.

Projektet e investimeve

në 000/lekë

Nr. i projekteve te investimit te rrugeve gjate viteve 2020 – 2022

- 60 rruge ne qytet.
- 16 rikualifikime urbane blloqe pallatesh ne qytet.

73 rruge ne NJA te ndara:

- 6 NJA Dajc.
- 10 NJA Berdice
- 13 NJA Velipoje
- 20 NJA Rrethina
- 7 NjA Ana malit
- 8 NjA Gur i ZI
- 9 NJA Postribe

(E3)LISTA EMERORE E PROJEKTEVE TE INVESTIMEVE /në 000 lekë

Emërtimi i projektit	2020	2021	2022
Blerje pajisje të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK)	3,000	3,000	3,000
Blerje vegla pune	300		
Blerje pajisje zyre për administratën e Bashkisë së Shkodrës	200	200	600
Implementimi i Kioskave Informative në territorin e Bashkië Shkodër dhe integrimi me platformat inovative të saj në funksion të qytetarëve, bizneseve, vizitorëve, etj.			8,000
Sistem Informacioni GIS i të dhenave vendore dhe i integruar me sistemet e tjera tëinformacionit si SiZ1N, SiTTV, Sistemin e Informacionit të Shërbimeve Sociale, etj...	800	600	
Sistem Informacioni i Integruar për Menaxhimin Financiar të Bashkisë Shkodër dhe Institucioneve e Varësive	2,000		
Blerje pajisje të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK)	400	400	400
Plotësimi i dokumentacionit ligjor teknik për masat MZSH dhe certifikimi për MZSH i të gjitha objekteve të vartësi të Bashkisë	1,000	1,000	1,000
Tregu i produkteve bujqesore Velipoje			25,000
Ndërtimi i tregut të shitjes me pakicë të produkteve agro-ushqimore lokale		20,000	
Blerje pompa sperkatje	300		
Mbledhje e informacionit / pergatitje materialesh per realizimin e rishikimit/hatimit te Planit te menaxhimit	1,146	1,146	1,146
Blerje kamion per sherbimin pyjor	1,167		
Investime per permiresim te fondit pyjor/kullisor	4,743	4,743	4,743

Investime ne bashkefinancim me Fondin Shqiptar te Zhvillimit (FSHZH) dhe Fondin e Zhvillimit te Rajoneve (FZHR)			
Shpronetime			
Rikualifikim Urban i Hyrjes se Qytetit te Shkodres dhe Parkut per Pushuesit			
Rikonstruksion Rruga Udhakryq	9,934		
Rikonstruksion Rruga Cen Broja	5,089		
Rikonstruksion rruge Bahcallek	3,327		
Rikonstruksion Degëzime Rruga e "Shirokës"	1,320	1,833	
Rikonstruksion Degëzim Rruga Hamz Kazazi	3,870	430	
Rikonstruksion degëzim Rruga "Hoxha Tahsim"	1,400	100	
Rikonstruksion Rruga "Rexhep Dizdari"	3,150	350	
Rikonstruksion Rrugët e brendshme Shiroke	3,000	5,300	
Rikonstruksion Rruga "Safet Hoxha"	720	2,880	
Rikonstruksion degëzim Rruga "Ibrahim Rugova"	340	1,360	
Rikonstruksion Rruga "Daniel Mozali"	1,000	4,000	3,000
Rikonstruksion i rrugës Vehbi Ismaili.			
Ndërtim trotuari Rruga nacionale (Rruga e "Tiranës"), Bahcallek	3,000	7,000	5,700
Rikonstruksion Rruga e "Vreshtave"			4,000
Sistem asfaltim KUB-i dhe rrugëve të brendshme Bahcallek			15,000
Rikonstruksion Rruga "Hamit Gjylbegu" .	3,025		
Rikonstruksion Rruga "Zabelej" .	3,458		
Rikonstruksion Rruga "1 Qershori"	5,000	5,000	5,000
Rikonstruksion Rruga e "Korpusit"	6,000	9,900	6,100
Rikonstruksion Rruga e "Myzyrit"	2,000		
Rikonstruksion degëzim Rruga "Lopcej"			2,100
Rikonstruksion Rruga "E Bisht Iqindisë"			7,000
Rikonstruksion Rruga "Muharrem Dragovija"			5,000
Rikonstruksion Rruga "Besa Shqiptare" dhe "Rruga "Pages"	5,000	6,000	2,000
Rikonstruksion Rruga "Ferrukej"			7,500
Rikonstruksion Rruga "Brioti" .	8,353	3,401	
Rikonstruksion Degëzim Rruga At Gjergj Fishta	2,250	250	
Rikonstruksion Rruga Gjon Shllaku	1,200	100	
Rikonstruksion Degëzim Rruga "Marin Biçikemi"	1,800	200	
Rikonstruksion Rruga "Karakaçej"	1,000	100	
Rikonstruksion degëzim Rruga "Pogej"	1,400	200	
Rikonstruksion degëzim Rruga "Lin Delia"	1,650	3,850	
Rikonstruksion Rruga "Magjoni"	3,800	5,000	6,200
Rikonstruksion degëzim Rruga "Treni i Mallrave"		720	1,680
Rikonstruksion degëzim Rruga "Pjetër Budi"		1,360	5,440
Rikonstruksion i rrugës Hafiz Ali Ulqinaku.	3,007	2,138	
Rikonstruksion i Rrugës "Ymer Prizreni"	2,000	4,000	
Rikonstruksion vazhdimi i Rrugës "Bardhosh Dani" në lidhje me Rrugën "Rrojej"		7,640	3,820

Rikonstruksion i Rrugës "Milosao"	1,000		2,500
Rikonstruksion i Rrugës "Riza Dani"	1,000		1,100
Rikonstruksion i Rrugës pranë shkollës "Ali Laçej"	2,000		8,138
Rikonstruksion i Rrugës "Dragushej"	3,300		3,700
Rikonstruksion degëzim i Rrugës "Qafë"			2,250
Rikonstruksion vazhdimi i Rrugës "Ajasëm"			3,000
Rikonstruksion vazhdimi i Rrugës "Enver Draçini" dhe rruga e "Depos"			7,000
Rikonstruksion i rrugës 9 Nuset			1,000
Rikonstruksion Rruga "Shasi" .	3,842		
Rikonstruksion Rruga "Mehmet Shpendi"	3,000	10,000	7,000
Rikonstruksion Rruga "Imzot Zef Simoni"	3,984		
Rikonstruksion Rruga e "Dalmaces"	975	5,525	
Rikonstruksion Rruga "Degrand"	2,000	1,700	
Rikonstruksion Rruga "Zhasin Hakard"	2,000	1,600	
Rikonstruksion Rruga "Gjino Berri"	2,000	1,700	
Rikonstruksion degëzim Rruga "Besnik Ceka"		3,500	
Rikonstruksion Rruga "At Zef Valentini"	4,650		3,850
Rikonstruksion Rruga "Gjon Gazulli"	4,500		12,000
Rikonstruksion Rruga "Milan Shuflaj"			5,000
Rikonstruksion Rruga e "Martirëve"			5,000
Rikonstruksion Rruga "Don Nikollë Kaçorri"			4,000
Rikonstruksion rrugë Shkodër Qendër			
Rikualifikim Urban blloqe banimi "Bulevardi Zogu i Pare" (Pas Furrës së bukës Hysaj)	2,295	405	
Rikonstruksion Blloku i Pallateve "Osja Falltores" (krahu i majte)	220	1,980	
Rikualifikim Urban Blloqe banimi Rruga e "Korpusit" (Enti Kombetar i Banesave)	1,000	6,500	3,500
Rikualifikim Urban Blloqe Banimi "Leke Dukagjini" (tek ish vajguri)	600	5,400	
Rikualifikim Urban Blloqe Banimi "Leke Dukagjini" - (tek Rajoni nr. 2)	660	5,983	
Rikualifikim Urban Blloqe banimi Rruga "Lëvizja e Postribës" (përballë Mërkatës)	230	2,070	
Rikualifikim Urban Blloqe banimi Rruga "Europa" (tek ish qendra ekonomike e arsimit)	4,000	1,000	
Rikualifikim Urban Bllok Pallatesh Rruga "Bashkimi"		3,300	2,200
Rikualifikim i bllokut urban, rruga Daut Boriçi.	5,000	1,967	
Rikonstruksion blloku pallateve (ish Rajoni nr.4) Rruga Bulevardi "Skenderbeg"	6,424	4,497	1,928
Rikonstruksion i Bllokut të pallateve "Mehmet Pashë Plaku" (afër servis Jubanit)	5,040	7,326	
Rikonstruksion i Bllokut të pallateve "Mehmet Pashë Plaku" (përballë Medreses)	3,600	400	
Rikonstruksion i Bllokut të pallateve "Mehmet Pashë Plaku" (përballë shkollës Ali Laçej)	3,109	2,009	3,100
Rikonstruksion i Bllokut të pallateve Rruga "Arkitekt Sinani"			6,930
Rikualifikim Urban Blloqe Banimi "Henrik Laca"	4,195	1,699	
Rikualifikim Urban Blloqe Banimi "Shtatë Shaljanët"	4,500	500	


Rikonstruksion Rruga " Zef Kakarriqi"			
Sistemim asfaltim Rrugë të brëndshme fshati "Samrisht i Vjetër".	6,288	3,150	
Sistemim asfaltim Rruga "Dajçit te ri"-(Shkolla e Mesme Dajç)	4,046		
Sistemim asfaltim Rruga "Darragjat", Dajç	4,520	6,665	11,655
Sistemim asfaltim Rruga "Pentar i Poshtëm"	1,520	5,865	
Sistemim asfaltim Rruga e fshatit "Shirq-Loti II "		1,665	4,655
Sistemim asfaltim Rruga "Mandajve"		665	2,655
Sistemim - Asfaltim i rrugës "Mollojsve", Bërdicë Sipërme	4,437		
Sistemim - Asfaltim i Rrugës se Varrezave te Fshatit Mali –Hebaj	5,949		
Sistemim dhe Asfaltim i Rrugës "Ramoshaj" në fshatin Trush	2520	2465	
Sistemim - Asfaltim i rrugës së Varrezave në fshatin Bërdicë e Mesme	1520	6665	
Sistemim - Asfaltim i Rrugës së "Xhurretëve" në fshatin Trush	2520	3365	
Sistemim - Asfaltim i Rrugës së "Përroit" Beltojë		315	5505
Sistemim - Asfaltim Degëzim i rrugës "Gjomarkaj"		160	1095
Sistemim dhe Asfaltim i Rrugës "Mehaj"		1330	1655
Sistemim - Asfaltim blloku qendër Bërdicë e Madhe			3155
Sistemim - Asfaltim Rrugë lidhëse Bërdicë e mesme - rrugë nacionale Velipojë			4455
Rikonstruksion Rrugë Velipojë Plazh	16,851	6,455	
Sistemim - Asfaltim Rrugë Velipojë Plazh loti III	8520	5665	
Sistemim Asfaltim Rrugë të Brendshme Fshati Gomsiqe	1520	7465	
Sistemim Asfaltim Rruga Prekaj, Fshati Sektor Velipoje	3620	3065	
Sistemim Asfaltim Rrugë të Brendshme Fshati Reç i Ri	5370	650	
Sistemim Asfaltim Rruga e Xhamisë, Luarzë	1820		
Sistemim Asfaltim Rruge te brendshme Luarzë		3,665	600
Sistemim Asfaltim Rrugë te Brendshme, Fshati Sektor Velipoje		665	6,455
Sistemim Asfaltim Rrugë të Brendshme Fshati Reç-Pulaj		330	4,655
Sistemim Asfaltim i rrugës së fshatit Ças			4,155
Rikonstruksion trotuari, Baks i Ri			2,155
Sistemim Asfaltim Rruga Viluni			6,310
Sistemim Asfaltim Rruga Baks-Rrjollë – Zhuraj			7,155
Sistemim asfaltim rruga Hamidije, Shtoj i Vjeter	8,750		
Sistemim asfaltim rruga nacionale pika Ada – By Pass	5,856	2,354	
Sistemim asfaltim rruga Myzyraj Dobraq	4,230		
Sistemim - Asfaltim Rruga "Myzyraj", loti II	2,000	8,000	3,500
Sistemim - Asfaltim Rruga e varrezave Bleran	4,020	165	4,655
Rehabilitimi i qendres në fshatin Shtoj i Ri	4,040	4,665	
Sistemim asfaltim rruge dytësore në fshatin Guci e Re	520	2,665	
Sistemim asfaltim rruge në fshatin Grudë e Re	1,520	4,665	

Sistemim asfaltim segmente rrugësh Rilindja-Demokracia- Hotit në Hot të Ri	520	2,665	
Sistemim asfaltim rruga Drini në Zues	1,520		
Sistemim - Asfaltim rrugë dytësore Bardhaj Bleran		2,330	3,310
Sistemim asfaltim rruge ne fshatin Grude e Re		2,465	
Sistemim asfaltim rruga Hidrovor, Loti 2, Dobraq			3,655
Sistemim asfaltim rrugë dytësore Shkolla e Vjetër dhe Kisha, Shtoj i Ri			2,655
Sistemim asfaltim rruga Todi Germenji në Shtoj të Ri			3,155
Sistemim asfaltim vazhdim i rrugës Dode Qarri në Shtoj të Ri			3,155
Sistemim asfaltim rruge në fshatin Shtoj i Vjetër			2,155
Sistemim asfaltim rruge në fshatin Golem			3,310
Sistemim asfaltim rruga Dani në Bardhaj			1,000
Sistemim asfaltim rruge dytësore në Zues			1,500
Rikonstruksion i rrugës Oblike – Velinaj – Alimetaj, Loti 2			
Rikonstruksion i rrugës Oblike – Velinaj – Alimetaj, Loti 3	6,857	4,193	
Sistemim - Asfaltim i rrugës Muriqan-Goricë.	6,876	4,334	
Sistemim - Asfaltim i rrugës Oblike – Velinaj – Alimetaj, Loti 4	3,520	5,665	
Sistemim - Asfaltim i rrugës Muriqan-Goricë (Loti 2)	2,220	3,768	5,355
Sistemim - Asfaltim i rrugës Oblike – Pallate		3,565	10,255
Sistemim - Asfaltim i rrugës Oblike Qender – Lagjja Lami dhe Rashkej			5,155
Rikonstruksion i rruges Rragam - Sheldi Loti 1			
Rikonstruksion i rruges Rragam - Sheldi Loti 2	7,564	5,345	
Sistemim - Asfaltim i rrugeve te brendëshme, fshati Guri i Zi, (Rruga e Xhamise, Loti 1).	4,332	1,870	
Sistemim - Asfaltim i rruges Vukatanë – Guri i Kuq, (Loti 1)	1520	5665	5655
Sistemim - Asfaltim i rrugës Rragam – Sheldi, (Loti 3)	4520	4665	
Sistemim - Asfaltim i rrugëve të lagjeve, fshatit Juban (Rruga "Rragame")	520	4665	
Sistemim - Asfaltim i rrugëve të lagjeve, fshatit Juban (Rruga "Balzaj")		665	4855
Sistemim - Asfaltim i rruges Vukatanë – Guri i Kuq, (Loti 2).			4655
Sistemim asfaltim rruga "Ura e mesit-Drisht"	1,724		
Sistemim asfaltim rruga Qender Mes – Kullaj	5,468	4,301	
Sistemim asfaltim rruga Qender Mes – Kullaj, faza II	2240	3000	
Sistemim asfaltim rruga Boks-Ura e Rrasekut faza e I	1520	4000	
Sistemim asfaltim rruga Qender Boks – Ura e Mesit	290	2610	
Sistemim asfaltim rruga Boks-Ura e Rrasekut faza e II		1665	5955
Sistemim asfaltim rruga Qender Mes – Kullaj, faza e III		1995	8655
Sistemim asfaltim rruga "Fshat i Ri - Dragoç".			5155
Sistemim asfaltim rruga Kullaj – Kullaj Suke			4155
Rikonstruksion rruge rurale			
Projekti PARK4SUMP	758	758	758
F.V Kufizues shpejtësie (bumpe gome)	2,100	0	

Blerje materiale për sinjalistikë ujore	800		
Investim ne përmirësimin e sinjalistikës rrugore horizontale dhe vertikale	4,000	6,983	6,983
Vendosja e tabelave orientuese dhe informuese ne Shkoder			400
Permiresim i aksesit se shpelles se Jubanit nepermjet venies ne kushte sigurie te shtegut qe te con ne kete shpelle.		650	
Permiresimi i aksesit te 7 shtigjeve ekzistuese per biciklela		1,600	
Rikualifikim urban i sheshit ne fshatin Zogaj	900		
Blerje Kazanesh	7500	12,144	
Ndertim xhepa kazanesh	500		
Investime			12,144
Projektim ,përgatitja e PDV për zonat e parashikuara në PPV	1,668	1,689	1,689
Projektim, rivlerësimi, realizimi dhe monitorimi i Sistemit të Adresave Bashkia Shkodër	500	500	500
Blerje mjete te ndryshme per punonjesit e njesise se ofrimit te sherbimit		400	400
Ndertim parcela te reja varrezash	4,000	5,500	
Investime ndricim rruge dytesore	8,000	9,252	9,252
Zevendesim shtyllash zinkat dhe ndricuesve te demyuar dekorativ	1,800	1,800	1,800
Investim ndricimi rruge kryesore	8,000	8,000	8,000
Ndertim fusha sportive	3,229		
Blerje prozhektore per ndricimin e fushes se stervitjes te Pallatit te Sportit "Qazim Dervishi"	100		
Blerje pajisje TIK	100		
Rikonstruksion terren sportiv (salla e ndeshjeve lojera me dore 700 m2)	1030		
Blerje orendi dhe pajisje zyre	100		
Instalime teknike,pajisje,instrumente dhe vegla pune	100		
Blerje pajisje pastrimi-fshese me korent profesionale	70		
Investime per menaxhimi i Sportklubi Vllaznia		1,500	1,500
Blerje pajisje TIK (skaner, Hard Disk)	110		
Fshese me korrent	20		
Blerje periodiku/ gazeta (shqip + i huaj)	100		
Blerje librash	940		
Shpenzime per aktivitetin		1,889	2,887
Te tjera pajisje zyre	500		
Shpenzime kapitale per institucione te Deges Ekonomike te Kultures		500	500
Blerje dhe vendosje ndricues ne forme spoti i bardhe x 60 cope, shina spoti te bardha 65 m/l, bashkuesakendor per shina 10 cope, Tel 2.5 30 m/l, Montim	300		
Rikonstruksion i sallave ekspozuese të Galerisë së Arteve Shkodër		1,000	
Blerje pajisje orendi për mobilim	900		
Blerje pajisje operacionale	600		
Blerje pajisje sistemi sigurimit	400		

Blerje vegla pune	400		
Mbeshtetje per infrastrukturen dhe sherbimet mbeshtetese arsimit baze dhe parashkollor		2,300	2,300
Vendosja e rrjetit dhe instalim kaldaje shkolla Martin Camaj		6,465	
Rikonstruksion fasada shkolla Seit Tagani Trush	2,505		
Rikonstruksioni pjesshem shkolla Azem Hajdari		2,216	24,939
Instalim i ngrohjes ne ndertesen e Shkolles Ismail Qemali		9,306	
Blerje pajisje orendi	500	500	500
Rikonstruksion i pjesshem i kopshtit" Haxhi Hajdari" Golem	3,000		
Rikonstruksion i pjesshem i kopshteve		3,000	3,000
Blerje pajisje sistemi sigurimit	400		
Blerje pajisje operacionale	100		
Blerje pajisje orendi për mobilim	1,500		
Mbeshtetje per infrastrukturen dhe sherbimet mbeshtetese		2,000	2,000
Rikonstruksion Shkolla Jordan Misja Faza II	16,400	8,000	
Ndertim fushe dhe sistemim oborri Shkolles mesme bashkuar "Adem Haxhija"			14,811
Rikonstruksion shkolla "Kol Idromeno"			14,798
Blerje pajisje operacionale	100		
Mbeshtetje per infrastrukturen dhe sherbimet mbeshtetese		100	100
Rikonstruksioni konvikte			2,894
Blerje pajisje orendi	350	400	400
Blerje pajisje TIK	95		
Rikonstruksion i godinave në pronësi të njëjësive të vetëqeverisjes vendore për strehim social (Ndërtim i ri, godina sociale, me kontinier 1+1 dhe 2+1)	43,196		
TOTALI	431,662	430,379	477,395

Treguesit kyç financiar



Në tre vitet e ardhshme, projektet e investimeve janë planifikuar në programin buxhetor rrjeti rrugor (rural + urban), planifikimi menaxhimi dhe administrimi, administrimi i pyjeve dhe kullotave, mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile, shërbimi i tregjeve, akreditimi dhe inspektimi, transporti publik, zhvillimi i turizmit, menaxhimi i mbetjeve, shërbime publike vendore, ndriçimi i rrugëve, kujdesi social për familjet dhe fëmijët, sport dhe argëtim, trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore, arsimit bazë dhe parashkollor, arsimit të përgjithshëm (mesëm), arsimit profesional, etj.

Sektorët Strategjikë



Programi buxhetor kujdesi social për familjet dhe fëmijët përbën rreth **34.42%** të buxhetit të tre viteve të ardhshme 2020 – 2022. Pjesën më të madhe të shpenzimeve e zënë shpenzimet korrente me rreth **95.6%** në vitin 2020, **95.9%** në vitin 2021 dhe **96%** në vitin 2022. Ndërsa shpenzimet për paga dhe sigurime zënë **4.3%** në vitin 2020, **4.1%** në vitin 2021 dhe **4%** në vitin 2022.



KUJDESI SOCIAL PËR FAMILJET DHE FËMIJËT



Programi buxhetor planifikimi, menaxhimi dhe administrimi përbën rreth **9.62%** të buxhetit të tre viteve të ardhshme 2020 – 2022. Pjesën më të madhe të shpenzimeve e zënë pagat dhe sigurimet shoqërore me **76.6%** në vitin 2020, **79.8%** në vitin 2021 dhe **76.6%** në vitin 2022. Ndërsa shpenzimet korrente zënë **21.2%** në vitin 2020, **18.9%** në vitin 2021 dhe **19.4%** në vitin 2022. Shpenzimet kapitale zënë **2.2%** të shpenzimeve totale në vitin 2020, **1.3%** në vitin 2021 dhe **4.0%** në vitin 2022.



PLANIFIKIMI MENAXHIMI DHE ADMINISTRIMI



Programi buxhetor arsimit bazë përfshirë arsimin parashkollor përbën rreth **9.66%** të buxhetit të tre viteve të ardhshme 2020 – 2022. Pjesën më të madhe të shpenzimeve e zënë shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore me rreth **75.1%** në vitin 2020, **71.3%** në vitin 2021 dhe **69.6%** në vitin 2022. Ndërsa shpenzimet korrente zënë **22%** në vitin 2020, **20.9%** në vitin 2021 dhe **20.6%** në vitin 2022. Shpenzimet kapitale zënë **2.9%** në vitin 2020, **7.9%** në vitin 2021 dhe **9.8%** në vitin 2022.



ARSIMI BAZË PËRFSHIRË ARSIMIN PARASHKOLLOR



Programi buxhetor rrjeti rrugor rural dhe urban përbën rreth **11.24%** të buxhetit të tre viteve të ardhshme 2020 – 2022. Pjesën më të madhe të shpenzimeve e zënë shpenzimet kapitale me rreth **90.8%** në vitin 2020, **90.9%** në vitin 2021 dhe **91%** në vitin 2022. Shpenzimet korrente zënë **9.2%** në vitin 2020, **9.1%** në vitin 2021 dhe **9%** në vitin 2022.



RRJETI RRUGOR (RURAL + URBAN)



BASHKIA SHKODER

PARAQITJE E PERGJITHSHME

BUXHETI I VITIT 2020

**PROGRAMI BUXHETOR
AFATMESEM 2020-2022**

BUXHETI I VITIT 2020

PROGRAMI BUXHETOR AFATMESEM

2020 - 2022 BASHKIA SHKODËR

“Bashkia Shkodër në 2030 do të jetë një qëndër e rëndësishme kombëtare, një portë e Shqipërisë në Ballkanin Perëndimor dhe një nyje e rëndësishme transporti. Bashkia Shkodër është lider i rajonit ekonomik Shkodër-Lezhë-Podgoricë dhe ndërvepron me sukses si pjesë e nënrajonëve natyrore, ndërkufitare e turistike.

Një bashki me një zhvillim territorial të integruar e cila garanton barazinë në shërbime dhe në akses ndaj qytetarëve dhe vizitorëve bazuar në një sistem policentrik të zhvillimit. Një qëndër primare me një cilësi të lartë jetese ku ballinat ujore dhe zonat historike gjallërojnë jetën urbane të Bashkisë Shkodër. Shkodra si një model ndërkombëtar për zhvillimin e pedalimit bazuar në kulturën qytetare të përdorimit të hapësirës së përbashkët dhe kombinimit të modaliteteve të ndryshme të transportit.

Zhvillimi Ekonomik dhe Urban ndërthuret me mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, historike e natyrore. Turizmi gjithëvjeter do të jetë një vlerë e shtuar në ekonominë vendore e kombëtare duke garantuar larmishmëri në zhvillim me anë të ekoturizmit, agro-turizmit, turizmit kulturor, malor e ujqor. Një Bashki e cila promovon dhe mbështet sipërmarrjet e reja duke tërhequr talentin vendas e rajonal.

Shkodra me një mjedis të pastër e cilësor si një bashki e aftë të përballojë presionet dhe krizat e ndryshme ekonomike, sociale e natyrore duke garantuar një cilësi të lartë jetese e zhvillimi. Shkodra bashkëjeton në harmoni me ujën dhe përballlet me sukses me rrezikun e përmytjeve”.

1. Vështrim i përgjithshëm

1.1 Situata e njësisë së vetëqeverisjes vendore

1.2 Çështje kryesore për projektet dhe politikat e bashkisë

1.3 Informacion financiar Kryesor

2. Orientimi afatgjatë i bashkisë

2.1 Strategjia e zhvillimit afatgjatë/strategjia territoriale

2.2 Sfidat kryesore të zhvillimit

3. Projektet kryesore të PBA-së 2020-2022

3.1 Paraqitja e projekteve kryesore – arsyet dhe përfituesit

3.2 Plani i shpenzimeve kapitale /projektplani 2020-2022

4. Informacion financiar

4.1 Supozimet e planifikimit

4.2 Burimi i të ardhurave- referuar tabelës F1 të FPT

4.2.1 Arsyet/Faktoret në planifikimin e të ardhurave ndër vite.

4.2.2 Tëardhurat nga Taksat Vendore

i. Të ardhurat nga Taksat e Ndara

ii. Te ardhurat nga Tarifat Vendore

iii. Te ardhura të tjera

4.3 Shpenzimet

4.4 Rezultati total i buxhetit

4.5 Informacion financiar suplementar

4.5.1 Huamarrje 6

4.5.2 Detyrime të prapambe tura

4.5.3 Treguesit financiarë

4.5.4 Rreziqet financiare dhe fiskale

6. Monitorimi i zbatimit të strategjisë së Zhvillimit të njësisë

7. Shtojcë

7.1 Vlerësimi i shpenzimeve të planifikuara si pjesë e paketës fiskale


7.2 Përshkrimi i metodologjisë së përlllogaritjes së të ardhurave

7.3 – Plani i fluksit monetar

1. Vështrim i përgjithshëm

1.1 Situata e njësisë së vetëqeverisjes vendore

Bashkia jonë tashmë përfshin një territor me një sipërfaqe prej 872.71 km², dhe një popullsi prej rreth 208,618 banorë të regjistruar. Bashkia e Shkodrës ka në përbërjen e saj 11 njësi administrative: Shkodër, Ana e Malit, Bërdicë, Dajç, Guri i Zi, Postribë, Pult, Rrethinat, Shalë, Shosh, Velipojë. Ajo ka nën administrimin e saj një qytet dhe 93 fshatra.



Me ndarjen e re territoriale dhe administrative ka një pozicion të tillë që mbulon zonën detare dhe bujqësore në jug të saj, gjithashtu edhe zonën më malore të Shqipërisë në veri. Ndërsa në pjesën perëndimore kufizohet nga Liqeni i Shkodrës, i cili ka një rëndësi mjaft të madhe kombëtare dhe ndërkutare në marrëdhënie me Malin e Zi. Parë pikërisht nga marrëdhëniet ndërkufitare, pozicioni i favorshëm gjeografik, mundëson lidhjet si territoriale po ashtu edhe ekonomike dhe natyrore të Shkodrës me Malin e Zi dhe Kosovën duke e kthyer kështu në një pozicion mjaft të favorshëm strategjik për gjithë rajonin.

Ndarja në Lagje dhe fshatra në Njësitë Administrative të Bashkisë së Shkodrës

Bashkia Shkodër	Nj.A	Fshatrat	Kufizimi Veri	Kufizimi Jug	Kufizimi Lindje	Kufizimi Perëndim
	Shkodër	Qyteti Shkodër 5 Lagje	Rrethina	Bërdicë, Guri i Zi	Rrethina, Guri i Zi	Liçeni i Shkodrës
	Ana e Malit	Oblikë, Babot, Muriqan, Shtuf, Dramosh, Oblikë e Sipërme, Obot, Vallas, Velinaj, Vidhgar	Shkodër	Lumi Buna Dajç	Rrethina	Mali i Zi
	Bërdicë	Bërdicë e Madhe, Bërdicë e Mesme, Bërdicë e Sipërme, Trush, Beltojë, Mali Hebaj	Shkodër	Bushat	Guri i Zi Lumi Drin	Dajç
	Dajç	Dajç, Samrisht i Ri, Samrisht i Sipërm, Belaj, Mali i Gjymtit, Pentar, Rrushkull, Mushan, Darragjat, Suka-Dajç, Shirq	Lumi Buna Ana e Malit Mali i Zi	Velipojë	Bërdicë Bushat	Lumi Buna
	Guri i Zi	Guri i Zi, Juban, Ganjollë, Kuç, Rrencë, Vukatanë, Gajtan, Rragam, Sheldi, Mazrek, Shpor	Postribë Shllak	Bushat Vau i Dejës	Vau i Dejës	Bërdicë Shkodër
	Postribë	Mes, Dragoç, Boks, Kullaj, Myselim, Drisht, Ura e shtrenjtë, Domen, Shakotë, Prekal, Vilëz	Pult Malësi e Madhe	Guri i Zi	Shllak	Rrethina
	Pult	Pog, Kir, Gjuraj, Plan, Xhan, Bruçaj, Mgull	Shalë Malësi e Madhe	Postribë Shllak	Shosh Shalë	Malësi e Madhe
	Rrethinat	Dobraç, Grudë e Re, Shtoj i Ri, Guci e Re, Shtoj i vjetër, Zues, Golem, Hoti i Ri, Bleran, Bardhaj	Gruemirë	Shkodër Guri i Zi	Postribë	Liçeni Shkodër
	Shalë	Breg-Lumi, Abat, Nicaj-Shale, Lekaj, Vuksanaj, Pecaj, Theth, Ndërlytaj, Gimaj, Nënnavriq, Lotaj	Kosove	Shosh Tropojë	Tropojë	Malësi e Madhe Pult
	Shosh	Ndrejaj, Nikaj-Shosh, Palaj, Pepsumaj, Brashtë	Shalë	Temal Shllak	Pult	Temal Tropoje Vau i Dejës
	Velipojë	Velipojë, Pulaj, Luarzë, Baks-Rrjoll, Gomsiqe, Baks i Ri, Pulaj, Reç i Ri, Ças, Mali Kolaj	Dajç	Deti Adriatik	Lezhe	Lumi Buna

Nga këndvështrimi strukturor demografik në Bashkinë Shkodër banojnë rreth 63 përqind e popullatës së qarkut Shkodër. Aktualisht kjo bashki ka një popullsi prej 208,618 banore. Perqëndrimi më i madh i popullsisë është në qytetin e Shkodrës me 55% të popullsisë (115,215 banorë), ndërsa për sa i përket njësive administrative, njësia me popullsinë më të madhe është ajo e Rrethinave me 26,399 banorë. Njësitë e tjera më të mëdha nisur nga numri i popullsisë janë: Guri i Zi me 12,003 banore, Postriba me 11,666 banore, Berdica me 9,811 banore, Velipoja me 9,715 banore dhe Dajci me 9,047 banore. Tre njësitë e tjera më të vogla për nga numri i popullsisë janë Ana e Malit me 6,094 banore, Pulti me 3,064 banore, si dhe Shale e Shosh me 5,600 banorë. Dëndësia mesatare e popullsisë është 239.87 banore/km². Parë nga këndvështrimi i raportit gjinor, popullsia e Bashkisë Shkodër ruan një diferencë të lehtë përsa i përket ndarjes gjinore të popullsisë, në meshkuj e femra duke shprehur një situatë gjinore pothuaj të balancuar.

Bashkia Shkodër karakterizohet nga një shumëllojshmëri aktivitetesh ekonomike ku mund të gjejmë elementë të industrisë, energjisë, zonave turistike dhe ekonomike. Vërehet se baza ekonomike përbëhet nga bizneset e vogla, të cilat janë edhe katalizatorë të zhvillimit, pasi krijimi, zhvillimi dhe përmirësimi i këtyre bizneseve përbën një potencial të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik. Bizneset kryesore që kontribuojnë në zhvillimin ekonomik janë kryesisht të orientuara në industrinë e lehtë prodhuese, në përpunimin dhe prodhimin e materialeve tekstile si dhe tregti e biznese shërbimesh. Si një zonë karakteristike prodhuese e produkteve bujqësore dhe blegtorale kemi prani të bizneseve agro përpunuese të lidhura drejtpërdrejt me tregtinë. Gjithashtu edhe prania e bizneseve të artizanatit të cilët kanë një traditë të vjetër në qytetin e Shkodrës, vazhdon akoma sot duke luajtur rol të veçantë në ekonominë vendore. Industria përpunuese përbën një nga potencialet më të mëdha të zhvillimit në Shkodër. Prania e zonës industriale në Shkodër, në të cilën janë përqëndruar biznese të mëdha përpunuese është një tjetër element me rëndësi në zhvillimin ekonomik, duke ofruar punësim dhe të ardhura për popullsinë.

Ndërsa në pjesën e ultësirës shtrihet një sipërfaqe e konsiderueshme tokash bujqësore e cila është një burim i rëndësishëm ekonomik për zonën në fjalë. Veçanërisht, njësitë administrative Bërdicë, Velipojë, Dajç, Gur i Zi dhe Postribë kanë një avantazh të konsiderueshëm përsa i përket zhvillimit të bujqësisë. Ndërkohë përsa i përket prodhimit, mund të thuhet se në Shkodër ka një larmishmëri kulturash bujqësore të cilat prodhohen në territorin e bashkisë në periudha të ndryshme kohore.

Struktura e punësimit sipas sektorëve i referohet periudhës së nëntë mujorit të vitit 2018:

- 25 % janë të punësuar në sektorin publik.
- 75 % janë të punësuar në sektorin privat.

Punësimi: Për vitin 2018 rezultoi se numri i të punësuarve në Bashkinë Shkodër është 27,753 persona, nga të cilat 7044 punonjës janë të punësuar në sektorin publik dhe 20,709 punonjës në sektorin privat. Numri më i madh i të punësuarve është në qytetin Shkodër, ndjekur nga Njësia Administrative Rrethina. Ndërsa njësitë administrative me numrin më të ulët të punësimit janë Postriba, Pulti, Shalë dhe Shosh. Megjithatë, vlerësimi real i numrit të punësuarve në vend vështirësohet për shkak të mosdeklarimit nga personat që ushtrojnë veprimtari ekonomike jobujqësore/bujqësore, por që nuk figurojnë të regjistruar. Prandaj mendohet se ky numër punësimi

është edhe më i lartë. Një dukuri e tillë është e lidhur me lëvizjet migruese, të cilat kanë sjellë një ulje të numrit të popullsisë në zonat rurale krahasuar me periudhën e fillim viteve '90, duke çuar në krijimin e qendrave urbane me dendësi populsi deri në 1500 banorë/km² (Bashkia Shkodër) dhe zona më pak tërheqëse për banim me dendësi prej 20 banorë/ km² (Shalë, Shosh, Pult). Kjo reflekton edhe përqendrimin ekonomik drejt qytetit Shkodër. Ndërveprim të dendur me qytetin e Shkodrës rezultojnë të kenë kryesisht njësitë Ana e Malit, Bërdicë, Dajç, Guri i Zi.

Bazuar në të dhënat paraprake të marra nga Drejtoria Rajonale e Punësimit për vitin 2018 rezulton se numri i të papunëve 19-64 vjeç është 5794 persona. Nga analiza e strukturës së papunësisë sipas grupmoshave, shkalla e papunësisë për popullsinë në moshë punë 19-39 vjeç është 36%, ndërsa përqindja e të papunëve të regjistruar të grupmoshës mbi 40 vjeç është më e lartë. Kjo ka lidhje me kërkesat në rritje të tregut të punës për mosha relativisht të reja. Për vitin 2018 rezultojnë të regjistruara si punë kërkuese të papuna 2850 femra ose 49% e totalit të të papunëve të regjistruara.

Një tjetër avantazh konkures i Bashkisë Shkodër si rrjedhojë e pozicionit të saj gjeografik është edhe zhvillimi i turizmit të shumëllojshëm dhe gjithë-vjetor. Kjo nënkupton zhvillimin e turizmit detar në zonën e Velipojës, zhvillimin e turizmit kulturor dhe historik, zhvillimin e turizmit malor, zhvillimin e eko-turizmit etj. Në zonën e Shkodrës ekziston një gamë e gjerë bukurish natyrore, që nga malet deri tek vija bregdetare e Adriatikut, nga brigjet e liqenit më të madh në Ballkan deri në muret shkëmbore të Kështjellës së Rozafës, e cila qëndron madhështore mbi një qytet i cili njëqind vjet më pare, nëpërmjet Lumit Buna sillte në zemër te tij mjaft anije tregtare dhe udhëtarë. Qyteti i Shkodrës me historinë e tij 2400 vjeçare është quajtur kryeqyteti i kulturës shqiptare, duke mbajtur akoma dëshmi dhe relike të historisë së gjatë dhe të trazuar, si kështjellat, kishat, xhamitë, muzeun arkeologjik, shtëpitë e rrugët e vjetra tradicionale, arkivin e vjetër e të rrallë të fotografive, evenimentet e ndryshme kulturore etj.

Duke qënë qëndra më e madhe urbane në rajonin veri-lindor Shkodra gjithashtu krijon mundësi të shumta në zhvillimi e sektorit të shërbimeve dhe të tregtisë. Në këtë mënyrë, Bashkia Shkodër, shihet si porta kryesore e veriut, duke konsideruar këtu edhe rolin influencues që ka në rajon me qytetet ndërkutare Mal i Zi Kosovë, Ulqin Podgoricë - Gjakovë, Prizren, Prishtinë dhe në shkallë kombëtare Rajoni Shkodër - Lezhe dhe Rajoni Kukës-Has-Tropojë.

1.2 Çështje kryesore për projektet dhe politikat e bashkisë¹

Bashkia Shkodër mbështet skenarin policentrik të zhvillimit të territorit të saj. Ky skenar paraqitet si koncept në dy nivele, si në nivelin Bashkiak, ku për qëllime të kohezionit territorial kërkohen disa qëndërsi të reja në ofrimin e shërbimeve bazë (shkollë, qëndër shëndetësore, postë), ashtu dhe në nivel qyteti, ku shërbimet dhe aktivitetet duhet të shpërndahen më shumë në territor. Zona urbane e Shkodrës ka nevojë të krijojë qëndërsi të reja urbane rreth qendrës historike. Këto qëndërsi të reja urbane konsolidojnë strukturën ekzistuese, pa ndikuar në tipologjitë historike të ndërtimit. Ndërkohë

¹Burimi i informacionit: PPV/PZHS

zonat rurale kanë nevojë për të përmirësuar qendrat ekzistuese. Kjo qasje do të ruajë tokën bujqësore dhe burimet natyrore. Pra nga njëra anë skenari i policentrizmit promovon shpërndarjen në territor të centraliteteve (sipas një hierarkie të caktuar) dhe një vëmendje më të madhe në përmirësimin e cilësisë urbane edhe në zonat rurale, ndërkohe që nga ana tjetër promovon kompaktësimin dhe konsolidimin e tyre për të mos u shpërhapur në territor. Ky skenar promovon një zhvillim shumë-dimensional të ekonomisë dhe arritjen e qëllimit për zhvillimin rajonal duke promovuar edhe kohezionin territorial. Gjithashtu, krijohet një hierarki qendrash nga primare urbane (qyteti Shkodër) deri tek qendra locale, të cilat ofrojnë shërbime bazë për komunitetin. Gjithashtu skenari policentrik promovon mbrojtjen e burimeve natyrore e ujore duke garantuar mundësinë për zhvillimin e turizmit gjithëvjetor sipas parashikimeve të PPK dhe PINS.

1.3 Informacion financiar Kryesor²

Hartimi i projektit buxhetor afatmesëm 2020-2022 është bere bazuar në ligjin Nr.139/2015“Për vetëqeverisjen vendore“, ligjin Nr.9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar , ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, ligjin 68/2017 date 27.4.2017 “ Per financat e veteqeverisjes vendore “ , udhezimit të Ministrise se Financave dhe Ekonomisënr. 23 date 30.07.2018 “ Per procedurat standarte te pergatitjes se programit buxhetor afatmesem te NJQV” , udhezimit të Ministrise se Financave dhe Ekonomisë nr. 7, datë27.02.2019 “ Per pergatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2020-2022”, dhe anekset plotësuese (Informacion mbi nivelin e transfertës së pakushtëzuar dhe specifike për njësitë e vetëqeverisjes vendore, Shtojca e programit buxhetor afatmesem 2020-2022 , Instrumenti i planifikimit të programit buxhetor afatmesëm për njësitë e vetëqeverisjes vendore, Udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.20 datë 10.07.2019 “Për përgatitjen e buxhetit vendor”, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit te buxhetit”; shkresa e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me nr. 20458 datë 11.11.2019 "Dërgohet për njoftim transferta e pakushtëzuar dhe specifike, per vitin 2020", shkresa e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me nr. 23198/1 datë 24.12.2019 "Mbi parashikimin e fondeve buxhetore të emergjencave civile, nga njësitë e vetqeverisjes vendore per vitin 2020".

Këshilli Bashkiak me VKB nr 83, datë 20.12.2018 ka miratuar kalendarin e përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm 2020-2022 dhe buxhetit vjetor 2020 të bashkisë Shkodër .

Në zbatim të këtij vendimi, kryetari i bashkisë, në rolin e nëpunësit autorizues ka përcaktuar veprimtarinë e punës të Ekipeve të Menaxhimit të Programit (EMP), si më poshte vijon:

- Vlerësimi dhe parashikimi i të ardhurave të miratura me Vendim të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e raportit të vlersimeve dhe parashikimeve afatmesme të të ardhurave të bashkisë Shkodër për vitet 2020-2022.;
- Vlerësimi i struktureve se programeve lidhur me planifikimin e buxhetor per periudhen 2020-2022,

²Burimi i informacionit: Nxjerrë nga Instrumenti i Planifikimit Financiar

- Analiza e politikave dhe objektivave të programeve sipas funksioneve të veta, të deleguara dhe atyre të financuara me transfertëspecifike duke marre në konsiderate të dhenat financiare të një viti me pare, vitit aktual dhe parashikimin dhe planifikimin per tre vitet e ardhshme.
- Lidhja e objektivave strategjike te percaktuara në Planin e Pergjithshëm Vendor me objektivat e programit Buxhetor Afatmesem.
- Prioriteteve të investimeve të miratuara në PPV dhe të konsultuara me qytetarët dhe grupet e interesit, në fushën e infrastrukturës publike.
- Analizes së shpenzimeve operative (dy vite më parë, viti aktual dhe për tre vitet e ardhshme).
- Analizes se parashikimit të shpërndarjes së burimeve financiare për periudhën 2020-2022, sipas çdo programi (per tre vitet e ardhshme).
- Analizës se vlerësimit të projekteve dhe lidhjen e tyre me programet e shpenzimeve publike.
- Analizes se sherbimeve të mirembajtjes se objekteve arsimore, administrative, rrugeve të brendshme dhe atyre rurale.
- Analizes se shpenzimeve të funksioneve të financuara me transfertëspecifike, të transferuara që nga viti 2016.

Bashkia e Shkodrës ka nënshkruar Kartën Evropiane në 8 Mars 2017, duke e bërë atë pjesë të dokumentave dhe instrumentave që orientojnë veprimet dhe hapat që ndërmerren në të gjitha aspektet e jetës: politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore. Menjëherë pas marrjes së këtij angazhimi publik, i gjithë stafi i Bashkisë Shkodër është angazhuar maksimalisht për zbatimin në praktikë të Kartës Evropiane.

Përveç përkushtimit për hartimin e *Planit të Veprimit për Barazinë Gjinore 2018-2020* për një periudhë relativisht të shkurtër kohore, Bashkia Shkodër është e para bashki që caktoi në buxhetin e saj vjetor një zë dhe fonde përkatëse, pikërisht për aktivitete për zbatimin e Kartës Evropiane.

Gjatë vitit 2018, si hap i parë i zbatimit në praktikë të *Kartës Evropiane për Barazi të burrave dhe grave në jetën vendore* Bashkia e Shkodrës ka përgatitur dhe miratuar *Planin e Veprimit për Barazinë Gjinore*. Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore, mbulon një tërësi fushash dhe në të parashikohen veprime që synojnë: respektimin e të drejtës themelore të barazisë ndërmjet grave dhe burrave, vajzave dhe djemve; trajtimin e çështjeve të pabarazive dhe diskriminimit; veprime për eliminimin e stereotipeve gjinore; pjesëmarrjen e balancuar të grave dhe burrave në vendim-marrjen politike e publike; aksesin në shërbime të ndryshme të hartuara sipas nevojave të veçanta të grave dhe burrave, vajzave dhe djemve, si dhe ofrimin e këtyre shërbimeve me cilësi e në respektim të parimeve të barazisë; integrimin e këndvështrimit gjinor në të gjitha planet dhe fushat për zhvillim të qëndrueshëm; planifikimin e mbështetur në burimet e duhura, etj.

Buxhetimi me pjesëmarrje – konsultimi i buxhetit të bashkisë për çdo program buxhetor; zhvillimi ekonomik, turizmi, investimet, shërbimet publike, shërbimet sociale, etj., me shoqërinë civile, komunitetin, biznesin dhe palë të interesuara: Në dëgjesat publike të realizuara nga Bashkia e Shkodrës gjatë vitit 2019 pjesëmarrëse në këto takime kanë qenë gra dhe burra, të cilët kanë diskutuar mbi nevojat e tyre në territor.

Hapja e çerdheve dhe kopshteve të reja, në shërbim të komunitetit me qëllim krijimin e mundësive për punësim të grave dhe vajzave – nëna. (1 çerdhe e re dhe 2 kopshte të reja; janë në projekt edhe 2 çerdhe dhe 2 kopshte të reja).

Planifikimi i shërbimeve publike, është realizuar sipas qasjes gjinore; shërbime dhe investime që i përgjigjen njëloj të dyja gjinive; mbledhja, largimi dhe trajtimi i mbetjeve urbane, prodhimi, trajtimi, transmetimi dhe furnizimi me ujë të pijshëm, shërbimi i dekorit publik dhe ndriçimi i mjediseve publike duke ndikuar kështu drejt për drejtë në sigurinë e vajzave dhe grave, banore në territorin e Bashkisë së Shkodrës.

Të gjitha aktivitetet sensibilizuese që organizohen nga Bashkia e Shkodrës, i kushtojnë vëmendje të veçantë qasjes gjinore dhe promovimit të rolit të gruas në shoqëri. Në 16 ditët e aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore, Bashkia e Shkodrës planifikon dhe zhvillon një sërë aktivitetesh sensibilizuese. Aktivitetet zhvillohen në bashkëpunim të ngushtë me partnerët e shoqërisë civile, institucionet publike dhe sigurisht median, me synim shpërndarjen e informacionit sa më gjerë. Organizime të veprimtarive ndërgjegjësuëse, si; aktivitete me të rinjtë, forume diskutimi, takime me grupe vulnerabël ndaj fenomenit dhunë në familje, emisione në media, etj., zhvillohen përgjatë të gjithë vitit, por theksi dhe intensiteti i tyre është në 16 ditët e aktivizmit.

Përfaqësimi i grave në politikë e vendimmarrje ka pësuar një përmirësim të dukshëm; Bashkia e Shkodrës drejtohet nga një grua.

Këshilli Bashkiak ka 51 anëtarë nga të cilët 25 gra. Stafi i Bashkisë Shkodër --- 55.1% janë gra dhe 44.9% janë meshkuj.

Një eksperiencë e tillë, është absolutisht një sfidë por edhe një motiv pozitiv për të shfaqur qartë mundësitë e femrave në politikë dhe vendimmarrje.

Bazuar në sa mësipër, mund të themi se sot ka një përpjekje të vetdijshme nga Bashkia Shkodër, që të përvetësojmë qasje të reja në fusha të ndryshme si administratë, investime, procese politike dhe jetë publike, në mënyrë që të fillojmë një ndryshim strukturor, që përkthehet në zbatim konkret të objektivave të barazisë gjinore në nivel qeverie vendore.

Bashkia Shkodër përballet me sfidën e menaxhimit të burimeve financiare të kufizuara përkundrejt nevojave gjithmonë në rritje për shërbime dhe investime kapitale. Në këtë kontekst, planifikimi strategjik i investimeve kapitale, në funksion të përmirësimit të cilësisë së shërbimeve publike në territoret në administrim, rezulton i domosdoshëm dhe një parakusht për zhvillimin ekonomik vendor. Ndaj, vlerësohet thelbësor fuqizimi dhe përmirësimi i performancës financiare në drejtim të rritjes së të ardhurave dhe uljes së shpenzimeve.

Në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve financiare të veta të bashkisë, përdorimi i instrumenteve financiarë si huaja nga sistemi bankar (në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi), fondet shtetërore nga (FZHR, FSHZH etj) të orientuara kryesisht në mbështetje të zhvillimit të infrastrukturës, fondet nga donatorët e huaj (Bashkimi European, Banka Botërore, USAID, UNDP, KfW, WBIF, SECO etj) për çështje që lidhen me trajtimin i mbetjeve dhe ujërave, asistencë teknike dhe ndërtim kapacitetesh apo edhe format e partneritetit publik-privat paraqesin një mundësi reale për realizimin e investimeve kapitale.

Në këtë drejtim, vlerësohet e domosdoshme rritja e kapaciteteve të bashkisë në drejtim të hartimit, menaxhimit, zbatimit dhe monitorimit të projekteve të investimeve nëpërmjet këtyre formave të financimit. Një burim tjetër të ardhurash i cili kërkon ngritje të kapaciteteve lokale është i lidhur me programet e huaja të tilla si programi për Bashkëpunimin Ndërkufitar IPA me Malin e Zi, IADSA, IPA ADRI-ION, HORIZON 2020. Në të dy këto programme është e rëndësishme që të krijohen strukturat e duhura të bashkëpunimit në mënyrë që të përfitohen projekte dhe të ardhura shtesë për realizimin e tyre.

Buxheti total i Bashkisë Shkodër për vitin 2020 është 2,969,318 mijë lekë, në vitin 2021 është planifikuar 2,917,971 mijë leke, ndërsa në vitin 2022 është planifikuar 3,017,947 mijë lekë.


Financimi i buxhetit realizohet nga:

- **Nga burimet e veta vendore**, ku përfshihen të ardhurat nga taksat vendore dhe taksat e ndara, të ardhurat nga tarifatat vendore, të ardhura të tjera dhe të ardhura që trashëgohen.
- **Nga grantet e projekteve të huaja dhe donacionet**, ku përfshihen grantet e përfituara përmes thirrjeve për propozime, për zbatimin e projekteve të financuara nga programet e Bashkëpunimit Ndërkufitar etj, në përputhje me ligjet për ratifikimin e marrëveshjeve të financimit dhe VKM-ve për miratim në parim të marrëveshjeve të financimit.
- **Nga burimet qendrore**, ku përfshihen transfertat e pakushtëzuar, transfertat specifike (e pakushtëzuar sektoriale) për funksionet e reja, që i janë transferuar Bashkisë dhe transfertat e kushtëzuar.

(000/lekë)


Nr.	BURIMET E FINANCIMIT TË BUXHETIT TË BASHKISË SHKODËR	VITI 2020	VITI 2021	VITI 2022
I	Nga burimet e veta vendore	813,318	821,559	836,899
1	Të ardhurat nga taksat lokale	397,062	399,818	402,584
2	Të ardhura nga taksat e ndara	89,735	92,439	95,144
3	Të ardhurat nga tarifat vendore	312,635	315,187	324,817
4	Të ardhura te tjera	13,886	14,115	14,354
II	Grante nga projektet e huaja dhe donacione	4,061	758	758
III	Nga burimet qendrore	2,077,343	2,095,654	2,180,290
1	Transferta e pakushtëzuar	648,181	726,624	772,600
3	Transferta specifike (e pakushtëzuar sektoriale)	373,193	373,193	391,853
2	Transferta e kushtëzuar	1,055,969	995,837	1,015,837
IV	Te ardhura qe trashegohen	74,596		
	TOTALI	2,969,318	2,917,971	3,017,947

BURIMET E FINANCIMIT TE PBA 2020-2022




Të ardhurat nga **burimet qendrore**, rezultojnë të jenë element dominues dhe përcaktues në strukturën dhe performancën e të ardhurave totale. Varësia financiare nga transfertat ndërqeveritare bën që planifikimi i investimeve kapitale të jetë subjekt i kushtëzuar pothuajse tërësisht nga vendimet e qeverisë qendrore.

Pavarësia financiare e Bashkisë Shkodër, matur si raport i të ardhurave të veta vendore ndaj të ardhurave totale, rezulton mesatarisht 29% për trevjeçarin 2020-2022. Niveli i të ardhurave vendore përcaktohet në masën më madhe nga performanca e taksave dhe tatimeve vendore.



Më poshtë jepet grafiku i transfertës së pakushtëzuar për Bashkinë Shkodër (përfshirë të gjitha NJA-të) që nga viti 2008 e në vazhdim. Siç shihet transfertat e akorduar në vitin 2016, vit pas reformës territoriale, është më e vogël se në të gjithë periudhën 2008-2015. Edhe për vitin 2017 transfertat e pakushtëzuar e alokuar për Bashkinë Shkodër, nuk arrinte në nivelet minimale të regjistruara gjatë periudhës 2008-2015. Ndërkohë që në vitin 2018 sipas ligjit të ri të financave vendore është rritur 9.2%, transfertat e pakushtëzuar në vitin 2019 ka një rritje më të vogël se në vitin 2018, me rreth 2.2 %.

Transferta e pakushtezuar ne vite Bashkia Shkoder me te gjitha njësité administrative



Viti 2008 Viti 2009 Viti 2010 Viti 2011 Viti 2012 Viti 2013 Viti 2014 Viti 2015 Viti 2016 Viti 2017 Viti 2018 Viti 2019 Viti 2020 Viti 2021 Viti 2022

Ne baze te shkresesse Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me nr. 20458 datë 11.11.2019 "Dërgohet për njoftim transferta e pakushtezuar dhe specifike, per vitin 2020", transferta e pakushtezuar ne vitin 2020 ka një rritje me rreth 4.6 % . Planifikimi ne vitin 2021 është me rritje rreth 12.1 % ndaj 2020. Ndersa ne 2022 është planifikuar me rritje 6.3% ne raport me 2021 .

Disa tregues të rëndësishëm për buxhetin:

- Të ardhurat e veta nga taksat dhe tarifat vendore per vitin 2020, zënë mesatarisht 27.4 % të totalit të buxhetit.
- Transferta e pakushtezuar zë mesatarisht 21.8% të totalit të buxhetit.
- Transferta e pakushtezuar sektoriale zë mesatarisht 12.6% të totalit të buxhetit.
- Transferta e kushtezuar zë mesatarisht 35.6% të totalit të buxhetit.
- Grante nga projekte te huaja ze 0.1 % te totalit te buxhetit .
- Te ardhura te trasheguara zene 2.5% te totalit buxhetit te vitit 2020.
- Të ardhurat nga taksat vendore per vitet 2020-2022 zënë mesatarisht 48.5 % të totalit të të ardhurave nga burimet e veta vendore.
- Të ardhurat nga taksat e ndara per vitet 2020-2022 zënë mesatarisht 11.2 % të totalit të të ardhurave nga burimet e veta vendore.
- Të ardhurat nga tarifat vendore per vitet 2020-2022 zënë mesatarisht 38.5 % të totalit të të ardhurave nga burimet e veta vendore.
- Të ardhurat nga burime të tjera ne vitet 2020-2022 zënë mesatarisht 1.7 % të totali të të ardhurave nga burimet e veta vendore.
- Totali i shpenzimeve te personelit per vitin 2020 është 713 088 mijë lekë dhe zë 24 % të totalit të shpenzimeve , per vitin 2021 është planifikuar 724 704 mijë lekë dhe ze 24.8 % te shpenzimeve dhe per vitin 2022 është planifikuar 733 788 mijë lekë dhe ze 24.3 % të totalit të shpenzimeve³.

³Tek totali shpenzimeve të personelit përfshihen fondet për:

- Totali i shpenzimeve operative per vitin 2020 është 666 083 mijë lekë, per vitin 2021 është planifikuar 648 944 mijë lekë dhe per vitin 2022 është planifikuar 671 701 mijë lekë dhe zënë mesatarisht 22.4 % të totalit të shpenzimeve.
- Totali i shpenzimeve per subvencione është 3 000 mijë lekë per vitin 2020 po e njejtë shume per vitin 2021 dhe per vitin 2022 dhe zënë mesatarisht 0.1 % të totalit të shpenzimeve.
- Totali i transfertave per vitin 2020 është 1 154 985 mijë lekë, per vitin 2021 është planifikuar 1 110 444 mijë lekë dhe per vitin 2022 është planifikuar 1 131 563 mijë lekë dhe zënë mesatarisht 38 % të totalit të shpenzimeve
- Totali i shpenzimeve kapitale per vitin 2020 është planifikuar 431 662 mijë lekë dhe ze 14.5% të totalit të shpenzimeve, per vitin 2021 jane planifikuar 430 379 mijë lekë dhe ze 14.7 % te totalit te shpenzimeve dhe ne vitin 2022 jane planifikuar 477 395 mijë lekë dhe ze 15.8 % te totalit te shpenzimeve.


Planifikimi i buxhetit për vitet 2020-2022 sipas klasifikimit ekonomik

000/lekë

Zërat e shpenzimeve	VITI 2020	VITI 2021	VITI 2022
Paga dhe sigurime shoqërore	713,088	724,704	733,788
Shpenzime operative	666,083	648,944	671,701
Subvencion	3,500	3,500	3,500
Transferta	1,154,985	1,110,444	1,131,563
Investime	431,662	430,379	477,395
Totali	2,969,318	2,917,971	3,017,947

- Administratën publike vendore të Bashkisë Shkodër, 271 punonjës;
- Shërbimi i gjendjes civile – funksion i deleguar, që financohet me transfertë të kushtëzuar - 20 punonjës;
- Policia Bashkiake, 24 punonjës;
- QKB – funksion i deleguar, financohet me transfertë të kushtëzuar, 2 punonjës,
- Punonjës të shërbimeve të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, funksion i ri, që financohet me transfertë specifike të përcaktuar për paga, 20 punonjës;
- Punonjës të administrimit të pyjeve, funksion i ri, që financohet me transfertë specifike të përcaktuar për paga, 14 punonjës me kohë të plotë pune, 10 me kohë të pjeshme;
- Punonjës të shërbimeve publike vendore, 39 punonjës të përhershëm, 30 me kohë të pjeshme;
- Sport klub “Vllaznia”, 21 punonjës dhe 37 me kohë të pjeshme;
- Institucione Kulturore si Biblioteka “Marin Barleti, Qendra Kulturore “Pjetër Gaci”, Galeria e Arteve, Teatri “Migjeni”, Muzeumet), 72 personel, artistë, specialistë, punonjës të shërbimeve;
- Institucione të arsimit parashkollor, 9 vjeçar dhe para universitar, 421 punonjës;
- Punonjës të institucioneve të kujdesit social, çerdhet - 67 punonjës dhe qendrat komunitare 14 punonjës dhe 4 me kontrate që financohen nga donatorët;;
- Punonjës të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi, , që financohet me transfertë specifike, 36;

Raporti i zerave te shpenzimeve mbi totalin sipas viteve



Planifikimi i buxhetit për vitet 2020-2022 sipas programeve
000/leke

Programi	Emertimi	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022
1110	Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi	282,462	283,045	292,225
1170	Gjendja civile	14,920	14,920	14,920
3140	Shërbimet e Policisë Vendore	20,418	20,997	21,373
3280	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	106,380	47,758	49,480
4130	Mbështetje për zhvillimin ekonomik	6,915	8,022	8,322
4160	Shërbimet e tregjeve, akreditimi dhe inspektimi	1,500	20,500	26,000
4220	Shërbimet bujqësore, inspektimi, ushqimi dhe mbrojtja e konsumatoreve	2,444	2,444	2,444
4240	Menaxhimi i Infrastruktues së ujitjes dhe kullimit	33,364	33,364	35,546
4260	Administrimi i pyjeve dhe kullotave	20,888	20,888	21,405
4520	Rrjeti rrugor rural	330,022	342,842	353,575
4570	Transporti publik	13,494	13,620	13,620
4760	Zhvillimi i turizmit	6,810	8,410	6,350
5100	Menaxhimi i mbetjeve	205,000	209,484	209,484
5200	Menaxhimi i ujrave të zeza dhe kanalizimeve	12,000	15,000	15,000
5320	Programet e mbrojtjes së mjedisit	-	-	-
5630	Ndërgjegjësimi mjedisor	-	-	-
6140	Planifikimi Urban Vendor	2,168	2,189	2,189
6260	Shërbime publike vendore	83,335	85,472	86,102
6330	Furnizimi me ujë	500	500	500
6440	Ndriçim rrugësh	97,761	98,380	109,676
7220	Shërbimet e kujdesit parësor	3,000	-	-
8130	Sport dhe argëtim	115,042	102,734	102,834
8220	Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore	87,665	89,895	91,036
9120	Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor.	283,697	302,022	313,272
9230	Arsimi i mesëm i përgjithshëm	54,064	46,123	69,041
9240	Arsimi profesional	61,758	61,758	64,652
10140	Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara	36,633	36,637	38,445
10220	Sigurimi shoqëror	-	-	-
10430	Kujdesi social për familjet dhe fëmijët	1,010,403	1,026,510	1,046,744
10661	Strehimi social	45,026	1,754	1,750
	Fond rezervë+kontigjencë	31,649	22,703	21,962
TOTALI		2,969,318	2,917,971	3,017,947

Gjatë vitit 2018-2019, përveç administrimit dhe dhënies së shërbimit ndaj qytetarëve në gjithë territorin e saj, bashkia menaxhoi burimet e veta dhe siguroi plotësisht të ardhurat buxhetore të parashikuara, të nevojshme për kryerjen e gjithë funksioneve të larmishme që bashkia ka.

Rëndësi e veçantë iu dha shfrytëzimit dhe vënies në efikasitet të aseteve të veta, implementimit të procedurave online e të thjeshta, zgjerimit të bazës taksapaguese, rritjes së nivelit të arkëtimeve nëpërmjet politikave lehtësuese, taksave të ulta dhe rritjes së frymës së konkurrencës së ndershme, thjeshtimit dhe standartizimit të procedurave, si dhe trajtimit të qytetarëve dhe bizneseve si partnerë të përbashkët të bashkisë.

Objektivat janë planifikimi buxhetor, llogaritja, analizimi dhe kontabilizimi i burimeve financiare të të ardhurave të veta, ndjekja e politikave dhe strategjive sensibilizuese, mbështetese dhe zhvilluese për krijimin e të ardhurave, zbutjes së informalitetit, rritjes së konkurrencës së ndershme, si dhe administrimi i marrëdhëniet me taksapaguesit dhe shërbimi ndaj tij.

Objektivat kryesisht janë të orientuara në lehtësimin maksimal fiskal dhe shpërndarjen e drejtë të ngarkesës tatimore, kanë ndikuar në nxitjen e zhvillimit dhe zgjerimit të biznesit, duke ruajtur dhe madje duke induktuar me efikasitet rritjen e të ardhurave për zërat kryesorë që lidhen me biznesin. Gjithashtu mundësimi i shlyerjes së pagesave pranë taksapaguesit, dhënia e shërbimeve të përmirësuara dhe informimi i taksapaguesit nëpërmjet zyrave me Një Ndalese dhe agjentit tatimor Ujesjelles Kanalizime të shpërndara gjeografikisht në territorin e bashkisë pranë qytetarit, si dhe shtrirja e përshtatja e afateve të pagesave me qëllim lehtësimin e taksapaguesit, kanë ndikuar në përmirësimin e vazhdueshëm të klimës së biznesit dhe marrëdhënies me taksapaguesin.

Objekti kryesor për realizimin e të ardhurave buxhetore të planifikuara për vitin 2018, është realizuar 103%, duke përmbushur pritshmëritë referuar planifikimit buxhetor. Tejkalimi i planit fillestar buxhetor të vitit 2018 ka ardhur kryesisht nga tejkalimi i planit për kategoritë “të ardhur të tjera dhe donacione” si rezultat i marrëveshjeve të bashkisë me donatorë dhe praktikantët e mira të ushtruara, vjelja e detyrimeve të prapambetura si rrjedhojë performancës së punës dhe e procedurave të aplikuara, masat administrative të vendosura nga inspektorati i mbrojtjes së territorit, si dhe dhënia me “qira e aseteve të bashkisë” në zbatim të vendimeve të këshillit bashkiak.

2. Orientimi afatgjatë i bashkisë

2.1 Strategjia e zhvillimit afatgjatë/strategjia territoriale⁴

Bazuar në direktivat kryesore të Planit të Përgjithshëm Kombëtar dhe Planit të Integruar Ndërsektorial të Bregdetit dhe në konsultim me palët e interesuara dhe qytetarët është hartuar objektivi afatgjatë për Bashkinë Shkodër:

⁴Burimi i informacionit: PPV/PZhS

“Bashkia Shkodër në 2030 do të jetë një qendër e rëndësishme kombëtare, një portë e Shqipërisë në Ballkanin Perëndimor dhe një nyje e rëndësishme transporti. Bashkia Shkodër është lider i rajonit ekonomik Shkodër-Lezhë-Podgoricë dhe ndërvepron me sukses si pjesë e nënrajoneve natyrore, ndërkufitare e turistike.

Një bashki me një zhvillim territorial të integruar e cila garanton barazinë në shërbime dhe në akses ndaj qytetarëve dhe vizitorëve bazuar në një sistem policentrik të zhvillimit. Një qendër primare me një cilësi të lartë jetese ku ballinat ujore dhe zonat historike gjallërojnë jetën urbane të Bashkisë Shkodër. Shkodra si një model ndërkombëtar për zhvillimin e pedalimit bazuar në kulturën qytetare të përdorimit të hapësirës së përbashkët dhe kombinimit të modaliteteve të ndryshme të transportit.

Zhvillimi Ekonomik dhe Urban ndërthuret me mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, historike e natyrore. Turizmi gjithëvjetor do të jetë një vlerë e shtuar në ekonominë vendore e kombëtare duke garantuar larmishmëri në zhvillim me anë të ekoturizmit, agro-turizmit, turizmit kulturor, malor e ujqor. Një Bashki e cila promovon dhe mbështet sipërmarrjet e reja duke tërhequr talentin vendas e rajonal.

Shkodra me një mjedis të pastër e cilësor si një bashki e aftë të përballojë presionet dhe krizat e ndryshme ekonomike, sociale e natyrore duke garantuar një cilësi të lartë jetese e zhvillimi. Shkodra bashkëjeton në harmoni me ujin dhe përballet me sukses me rrezikun e përmytjeve”.

Në përmbushje të këtij vizioni, janë hartuar 5 objektiva strategjike, të cilët synojnë të specifikojnë fokusin e zhvillimit të Bashkisë gjatë viteve të ardhshme. Është synuar që objektivat strategjike të jenë të prekshme, specifike dhe të monitorueshme, për të siguruar zbatueshmërinë e tyre. Për këtë arsye, janë përcaktuar edhe disa tregues monitorimi e vlerësimi për secilin objektiv strategjik, të cilët mund të detajohen dhe përmirësohen gjatë punës që Bashkia do të kryejë për zbatimin e kësaj strategjie.

Objektivi Strategjik 1- Përmirësimi Aksesit dhe Marrëdhënieve Rajonale

- **Programi Strategjik OS1PS1:** Terminalët multimodale
Programi Buxhetor
045 Transporti
- **Programi Strategjik OS1PS2:** Rregullimi i portave hyrëse në Shkodër
Programi Buxhetor
045 Transporti
- **Programi Strategjik OS1PS3:** Lidhjet strategjike rajonale e kombëtare
Programi Buxhetor
045. Transporti
- **Programi Strategjik OS1PS4:** Bashkëpunimi ndërkufitar
Programi Buxhetor
041: Çështje të përgjithshme ekonomike, tregtare dhe të punës

045. Transporti

Objektivi Strategjik 2- Integrimi Territorial dhe Barazia në Shërbime e Akses

- **Programi Strategjik OS2PS1:** Centralitete të reja në Bashkinë Shkodër (Policentrizmi)
Programi Buxhetor
061: Urbanistika
062 Zhvillimi i komunitetit

- **Programi Strategjik OS2PS2:** Konsolidimi i lidhjeve të qendrave kryesore urbane
Programi Buxhetor
045: Transporti
061: Urbanistika
062: Zhvillimi i komunitetit

- **Programi Strategjik OS2PS3:** Qendrat me një ndalesë dhe ngritja e kapaciteteve Lokale
Programi Buxhetor
011. Organet ekzekutive dhe legjislativë, çështjet financiare dhe fiskale, çështjet e brendshme
061: Urbanistika
062: Zhvillimi i komunitetit

- **Programi Strategjik OS2PS4:** Qeverisja elektronike
Programi Buxhetor
011. Organet ekzekutive dhe legjislativë, çështjet financiare dhe fiskale, çështjet e brendshme

- **Programi Strategjik OS2PS5:** Qendrat multifunksionale dhe shërbimet sociale
Programi Buxhetor
072. Shërbimi kujdesit paresor
091. Arsimi bazë dhe parashkollor
092. Arsimi i mesëm
101: Sëmundje dhe paaftësi
102: Të moshuarit
104: Familja dhe Fëmijët

Objektivi Strategjik 3- Konkuroshmëria dhe Zhvillimi Ekonomik

- **Programi Strategjik OS3PS1:** Zhvillimi rural
Programi Buxhetor
041: Çështje të përgjithshme ekonomike, tregtare dhe të punës
042. Bujqësi, peshkim, pyje dhe gjuetia

- **Programi Strategjik OS3PS2:** Zhvillimi akuakulturës
Programi Buxhetor
042 Bujqësia, pyjet, peshkimi dhe gjuetia

- **Programi Strategjik OS3PS3:** Zhvillimi turizmit

Programi Buxhetor

047. Industri të tjera

- **Programi Strategjik OS3PS4:** Mbështetja e sipërmarrjeve të reja

Programi Buxhetor

041: Çështje të përgjithshme ekonomike, tregtare dhe të punës

- **Programi Strategjik OS3PS5:** Zhvillimi i zonave ekonomike

Programi Buxhetor

041: Çështje të përgjithshme ekonomike, tregtare dhe të punës

- **Programi Strategjik OS3PS6:** Branding i Bashkisë Shkodër

Programi Buxhetor

041: Çështje të përgjithshme ekonomike, tregtare dhe të punës

042: Bujqesia, pyjet, peshkimi dhe gjuetia

047: Industri të tjera

Objekti Strategjik 4- Cilësia e Lartë e Jetesës dhe Zhvillimit Urban

Programi Buxhetor

031: Shërbimet policore

- **Programi Strategjik OS4PS1:** Rikualifikimi i ballinave ujore

Programi Buxhetor

061: Urbanistika

- **Programi Strategjik OS4PS2:** Restaurimi i ndërtesave historike dhe mbrojtja e trashëgimisë historike e kulturore

Programi Buxhetor

061: Urbanistika

- **Programi Strategjik OS4PS3:** Rikualifikimi i hapësirave industriale dhe përdorimi i 'Broënfield'

Programi Buxhetor

041: Çështje të përgjithshme ekonomike, tregtare dhe të punës

061: Urbanistika

- **Programi Strategjik OS4PS4:** Urbanizimi i zonave informale

Programi Buxhetor

061: Urbanistika

062. Zhvillimi i komunitetit

- **Programi Strategjik OS4PS5:** Rigjenerimi urban

Programi Buxhetor

061: Urbanistika

062. Zhvillimi i komunitetit

- **Programi Strategjik OS4PS6:** Përmirësimi dhe integrimi i komuniteteve rome dhe egjyptiane
Programi Buxhetor
 062. Zhvillimi i komunitetit
 104: Familja dhe fëmijët
 106: Strehimi social
- **Program Strategjik OS4PS7:** Përmirësimi i qendrave të njësive administrative, përmes ndërhyrjeve të rikualifikimit urban
Programi Buxhetor
 061 Urbanistika
- **Programi Strategjik OS4PS8:** Hapësirat publike; Hapësirat rekreative dhe sportive
Programi Buxhetor
 061 Urbanistika
 062. Zhvillimi i komunitetit
 081. Shërbime rekreative dhe sportive
- **Program Strategjik OS4PS9:** Përmirësimi i infrastrukturës nëntokësore të ujësjellësit dhe KUZ
Programi Buxhetor
 052. Menaxhim i ujërave të zeza
 063. Furnizimi me ujë
- **Programi Strategjik OS4PS10:** Strehimi social dhe i përballeshëm
Programi Buxhetor
 106: Strehimi Social
- **Programi Strategjik OS4PS11:** Efiçienca energjitike dhe energjia e rinovueshme
Programi Buxhetor
 064. Ndriçimi rrugor
- **Programi Strategjik OS4PS12:** Transporti publik
Programi Buxhetor
 045. Transporti
- **Programi Strategjik OS4PS13:** Bicikletat
Programi Buxhetor
 045. Transporti
- **Programi Strategjik OS4PS14:** Gjallëria urbane
Programi Buxhetor
 047. Industri të tjera
 081: Shërbimet rekreative dhe sportive
 082. Shërbimet kulturore
- **Programi Strategjik OS4PS15:** Parkimet

Programi Buxhetor

045. Transporti

Objektivi Strategjik 5- Mbrojtja e mjedisit dhe aftësia për tu përshtatur, mbrojtur dhe rimëkëmbur nga rreziqet natyrore

- **Programi Strategjik OS5PS1:** Mbrojtja e mjedisit
Programi Buxhetor
051. Menaxhimi i mbetjeve
052. Menaxhim i ujërave të zeza
053. Reduktimi i ndotjes
056. Mbrojtja mjedisore
- **Programi Strategjik OS5PS2:** Mbrojtja nga përmbytjet
Programi Buxhetor
032: Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile
- **Programi Strategjik OS5PS3:** Përmirësimi i shërbimit të menaxhimit të mbetjeve urbane
Programi Buxhetor
051. Menaxhimi i mbetjeve
- **Programi Strategjik OS5PS4:** Mbrojtja e akuifereve nga ndotja
Programi Buxhetor
056. Mbrojtja mjedisore
- **Programi Strategjik OS5PS5:** Qendra e menaxhimit nga risku i përmbytjeve
Programi Buxhetor
032: Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile
- **Programi Strategjik OS5PS6:** Menaxhimi i rreziqeve natyrore
Programi Buxhetor
032: Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile
- **Programi Strategjik OS5PS7:** Menaxhim i pyjeve dhe kullotave
Programi Buxhetor
042. Bujqësi, peshkim, pyje dhe gjuetia
- **Programi Strategjik OS5 PS8:** Ndryshimet klimatike
Programi Buxhetor
056. Mbrojtja mjedisore

2.2 Sfidat kryesore të zhvillimit⁵

- Është e rëndësishme ndërlidhja më e mirë e Bashkisë Shkodër në nivel rajonal duke shfrytëzuar transportin rrugor, hekurudhor dhe ujor.

⁵Burimi i informacionit: PPV/PZhS; të tjera

- Përmirësimi i aksesit në zonat rurale me qëllim zbutjen e pabarazive dhe ofrimin e shërbimeve administrative në të gjithë territorin e Bashkisë.
- Promovimi i rigjenerimit të ish-zonave industriale si dhe ndërlidhja më e mirë e kësaj zonë me dy akse prioritare ekonomike Shkodër-Lezhë dhe Shkodër-Koplik, duke krijuar vazhdimësi dhe duke forcuar rolin e zonës ekonomike si pjesë e rajonit ekonomik Shkodër-Lezhë dhe rajonit ndërkufitar Podgoricë-Shkodër nga direktivat e PPK dhe PINS Bregdeti.
- Menaxhimi sa më të mirë i mbetjeve. Bashkia Shkodër do të promovojë riciklimin e mbetjeve urbane dhe ndarjen e mbetjeve që në burim, duke krijuar kosha të diferencuar.
- Zhvillimi ekonomik me theks në mjedis mjedisit në mënyrë që të garantohet mbrojtja e ekosistemeve dhe vlerave të shumta natyrore të Shkodrës. Boshtet kryesore të zhvillimit ekonomik do të jenë zhvillimi rural (bujqësia dhe blegtoria), turizmi, industria e lehtë/përpunimi, shërbimet, dhe ekonomia e të ardhmes e bazuar në sistemet e teknologjisë së informacionit, ekonomia blu dhe ajo e gjelbër.
- Kujdes i veçantë duhet të tregohet për integrimin e brezave të rinj në ekonomi, dhe krijimin e mundësive për iniciativat në kuadër të rritjes së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.
- Integrimi i turizmit me sektore të tjerë të ekonomisë.

3. Projektet kryesore të PBA-së 2020-2022

3.1 Paraqitja e projekteve kryesore – arsyet dhe përfituesit⁶

Materialin e plotë të Projekteve kryesore të investimeve kapitale të PBA-së 2020-2022 të lidhura me PPV mund ta gjeni të publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë Shkodër:

http://www.bashkiashkoder.gov.al/web/tabela_2005.pdf

3.2 Plani i shpenzimeve kapitale /projektplani 2020-2022

Bashkëngjitur –Shpenzimet kapitale 2017-2022 (F15 – sheet i FPT).
Marrë nga Instrumenti i Planifikimit Financiar, [F15]
Informacion shtesë: [C1b]; [F2], [F6], [F16]

4. Informacion financiar

4.1 Supozimet e planifikimit

Tabela D2 jep llogaritjet makroekonomike për të cilat kemi informacion vetëm kursin e kembimit valutor që është dhënë në udhëzimin plotësues 7 datë 27.2.2019 “ Per buxhetin vendor” .Kjo tabelë

⁶Burimi i informacionit: Fishat e projekteve të PPV/PZhS

nuk ndikon ne produktet e tabelave te FPT (Financial Planning Tool – Instrumenti I planifikimit financiar).

Tabela D2 është pjese e tabelave te FPT.

4.2 Burimi i të ardhurave- referuar tabelës F1 të FPT

4.2.1 Arsyet/Faktoret në planifikimin e të ardhurave ndër vite.

Të ardhurat e veta përfshijnë të gjitha burimet e të ardhurave, me përjashtim të transfertës nga burimet qendrore. Këto burime të ardhurash bashkia i përdor për financimin e funksioneve të përcaktuara nga Ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Planifikimi i të ardhurave nga taksat/tarifat është mbështetur në paketën fiskale të Bashkisë Shkodër, e cila përcakton llojet e taksave, bazën e taksueshme, kategorizimet dhe nënkategorizimet, këstet e pagimit, kohën e kryerjes së tyre, efektet e lehtësive, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve dhe agjentët tatimorë.

Paketa fiskale përcakton rregullat për mënyrën e ushtrimit të të drejtave dhe të detyrave nga organet e qeverisjes vendore, për vendosjen e taksave vendore, mbledhjen dhe administrimin e tyre.

Në mënyrë të hollësishme, përveç strukturimit, detajon çdo lloj takse të administruar nga organet vendore të administrimit, përcakton qartë edhe administrimin e saj duke filluar me mënyrën e llogaritjes, personat përgjegjës të pagimit të taksës dhe ato të mbledhjes së saj.

Në hartimin e paketës fiskale të Bashkisë së Shkodrës janë përfshirë përfaqësues të biznesit të madh dhe të vogël, banorë të njësisë administrative, përfaqësues të komunitetit sipas interesit dhe përfaqësues të partive politike e këshilltarë.

Diskutimet publike janë organizuar në çdo njësi administrative dhe në qytet. Për ndryshimet dhe përditësimet e paketës fiskale janë bërë takime consultative gjithpërfshirëse. Gjatë këtyre takimeve bashkëqytetarë, banorë, përfaqësues të grupeve të interesit, është diskutuar dhe janë bërë propozime për përmirësim.

Paketa fiskale e bashkisë Shkodër, pasqyron disa politika të rëndësishme për uljen e disa niveleve ligjore/kufi, etj. sipas kompetencave ligjore, si më poshtë:

Politikat incentive në taksë:

- Ulje e taksës së ndërtesës për qëllime banimi në Nj.A. në 30% nga referenca ligjore
- Taksë banese zero për pensionistët dhe përfituesit e ndihmës ekonomike
- Ulje e taksës së ndërtesës për qëllime biznesi në Nj.A. në 30% nga referenca ligjore
- Ulje në nivelin maksimal të lejuar prej 30% të taksës së tokës bujqësore
- Ulje deri në nivelin minimal ligjor për taksën e ndikimit në infrastrukturë

Politikat incentive dhe uljet nën nivelet e kostos së shërbimit të llogaritur:

- Tarifa zero për shërbimin e gjelbërimit për zonat rurale
- Tarifa minimale deri në zero për shërbimin e ndriçimit publik në zonat rurale

- Tarifa zero për familjet me ndihmë ekonomike.
- Tarifa të reduktuara 50% sipas kriterëve për pensionistë, invalidë, etj.
- Tarifa 0 (zero) për fermerët që janë regjistruar me NIPT nga Drejtoria Tatimore
- Tarifa të ulëta pastrimi, dhe pa tarifa të tjera për ambulancat

Bashkia Shkodër, tashmë, ka ndërtuar një system të integruar me një ndalesë për regjistrimin dhe shërbimin për taksapaguesit biznes dhe familje të shpërndarë në të gjithë territorin e Bashkisë. Janë ndërtuar bazat e të dhënave gjithnjë e më të sakta të taksapaguesve, sipas kategorive, biznes dhe familje, dhe nga viti në vit janë konsoliduar dhe siguruar të dhëna gjithnjë e më të sakta për bazën e taksueshme dhe nivelin e aplikueshëm të tarifave sipas llojit.

Është mundësuar lidhja on-line me sistemin e Kadastrës Fiskale që administrohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksës së Pasurisë, dhe ka filluar përditësimi i të dhënave për subjektet dhe familjet.

Sipas ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 35/2, bashkitë e ushtrojnë të drejtën e vendosjes së nivelit të taksës, mënyrën e logaritjes së saj, si dhe mbledhjen e administrimit të tyre brenda kufijve e sipas kriterëve të përcaktuara me ligj.

Llogaritja e të ardhurave mbështetet në:


1. Ligjin nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar;
2. Ligjin nr.9920 datë 26.05.2008 “Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë“ i ndryshuar;
3. Vendimin e Këshillit të Bashkisë Shkodër nr 1 date 22.01.2016 ”Për miratimin e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Shkodër“, i ndryshuar;
4. Ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Të ardhurat nga burimet e veta vendore përfshijnë të ardhurat nga taksat vendore, të ardhura nga taksat e ndara, nga tarifatat vendore, dhe të ardhurat e tjera.

Tabela 1 Të ardhurat nga burimet e veta vendore

	Viti 2017	Viti 2018	I pritshmi Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022
Të ardhurat e veta	612,033	702,144	700,654	817,379	822,317	837,657
Të ardhura nga taksat vendore	278,096	280,071	313,463	397,063	399,818	402,585
Të ardhura nga taksat e ndara	57,207	81,214	74,560	89,735	92,439	95,144
Të ardhura nga tarifatat vendore	241,838	305,624	287,428	312,635	315,187	324,817
Të ardhura të tjera +grante nderkombetare+donacione	34,892	35,234	25,203	17,946	14,873	15,111

Të ardhurat e veta



Grafiku 1 Të ardhurat nga burimet e veta

Të ardhurat e veta, tatimore që mbledhen nga administrata e Bashkisë në vitin 2020 programohet të jenë 817,379 mijë lekë, me rritje +11,8 % ose 125,369 mijë lekë krahasuar me të pritshmin e vitit 2019, duke vijuar në vitet në vazhdim 2021,2022 me një rritje mesatare prej 10%.

Të ardhurat nga taksat vendore parashikohen të jenë 397,063 mijë lekë, me një rritje prej me rritje +12,6 % ose 83,600 mijë lekë.

Të ardhurat nga taksat e ndara parashikohen të jenë 89,735 mijë lekë, me një rritje prej me rritje +12 % ose 15,175 mijë lekë.

Të ardhurat nga tarifatat vendore parashikohen të jenë 312,635 mijë lekë, me një rritje prej me rritje +10,9 % ose 25,210 mijë lekë.

Të ardhurat e tjera parashikohen të jenë 17,946 mijë lekë, me një rritje prej me rritje +10,8 % ose 1,387 mijë lekë.

Kategoritë e taksave dhe tarifave që ndikojnë më shumë në planin e të ardhurave nga burimet e veta për vitin 2020 janë kryesisht taksa e ndikimit në infrastrukturë që zë rreth 23%, tarifa për pastrimin që zë rreth 21%, taksa e pasurisë së paluajtshme që zë rreth 21%, taksa e qarkullimit të mjeteve të përdorura që zë rreth 9%, tarifa e zënies së hapësirës publike që zë rreth 5%, tarifa e ndriçimit publik që zë rreth 5%. Këto zëra kryesorë mbulojnë rreth 82% të planit të të ardhurave të Bashkisë Shkodër.

Ndikimi i taksave dhe tarifave në planin e të ardhurave




Tabela e mëposhtme pasqyron planin e të ardhurave të veta, të kategorizuar sipas klasifikimit ekonomik ligjor:

Planifikimi i të ardhurave të veta për vitet 2020-2022 paraqitet si më poshtë:

në mijë lekë

LLOJET E TË ARDHURAVE	Plan 2020	Plan 2021	Plan 2022
TË ARDHURATE VETA	817,379	822,317	837,657
TË ARDHURA NGA TAKSATVENDORE	397,063	399,818	402,585
Të ardhura nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesine vogël	7,500	7,650	7,800
Të ardhura nga taksa mbi Biznesin e vogel (e prapambetur)	50	50	50
Te ardhura nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme	171,666	173,783	175,910
Të ardhura nga taksa e fjetjes në hotel	17,000	17,340	17,680
Të ardhura nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	185,000	185,000	185,000
Të ardhura nga taksa e tabelës	15,847	15,995	16,145
TË ARDHURA NGA TAKSATE NDARA	89,735	92,439	95,144
Të ardhura nga taksa vjetore per qarkullimin e mjeteve të përdorura	70,000	72,100	74,200
Të ardhura nga taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme	14,000	14,560	15,120
Të ardhura nga taksa e rentës minerare	35	35	35
Të ardhura nga tatimi mbi te ardhurat personale	5,700	5,744	5,789
TE ARDHURA NGA TARIFATVENDORE	312,635	315,187	324,817
Te ardhura nga tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave	167,867	168,879	169,935
Të ardhura nga tarifa për ndriçimin publik	39,443	43,399	48,339
Të ardhura nga tarifa për gjelbrimin	21,648	21,796	21,957
Të ardhura nga tarifa të shërbimit administrativ të bashkisë	83,677	81,113	84,586
Nga tarifa shërbimie administrative, kontroll zhvillim territorit, AMTP, etj.	3,400	3,502	3,604
Nga tarifa për vulosje veterinare të bagëtive të therura	616	616	616
Nga Tarifat e licënsimit të veprimtarive të transportit	1,000	1,050	1,100
Nga tarifa parkimi për mjetet e licënuara, dhe për vendparkime publike	4,133	4,508	4,917
Nga tarifë për dhënie licënsa për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj	10,000	6,000	8,000
Nga tarifat në sektorin e pyjeve dhe kullotave.	580	580	580
Nga tarifat e shërbimeve që kryen struktura e MKZ	1,999	2,056	2,114
Nga tarifa për zënien e hapësirave publike	36,800	37,536	38,272
Nga linjat ajrore dhe nëntokësore (Telefoni, Energji, TV Kabllor, Internet)	500	500	500
Nga dokumentat për tender, ankand etj.	11	12	13
Nga tarifa të institucioneve të arsimit, kultures, sportit, etj	24,638	24,753	24,870
<i>Biblioteka "Marin Barleti"</i>	<i>118</i>	<i>120</i>	<i>122</i>
<i>Muzeumet</i>	<i>2,950</i>	<i>2,971</i>	<i>2,992</i>
<i>Teatri "Migjeni"</i>	<i>3,570</i>	<i>3,605</i>	<i>3,641</i>
<i>Qendra Kulturore e fëmijëve</i>	<i>170</i>	<i>177</i>	<i>185</i>
<i>Pallati sportit "Qazim Dervishi"</i>	<i>600</i>	<i>650</i>	<i>700</i>


<i>Stadiumi "Loro Boriçi"</i>	800	800	800
<i>Nga mensat (konviktet)</i>	30	30	30
<i>Nga kopshet</i>	11,100	11,100	11,100
<i>Nga çerdhet</i>	5,300	5,300	5,300
TË ARDHURA TË TJERA	17,946	14,873	15,111
Të ardhura nga kundravajtjet administrative (Gjobat)	7,345	7,524	7,708
Të ardhura nga dhënia me qira e asetëve në pronësi të Bashkisë	3,190	3,190	3,190
Të ardhura nga sekuestrime dhe zhëmtime	3,030	3,060	3,091
Grante nga ndihma nderkombetare	4,061	758	758
Të ardhura nga shitja e mallrave dhe e shërbimeve	0	0	0
Shitja e asetëve fikse të prekshme / paprekshme	0	0	0
Të ardhura nga privatizimi	0	0	0
Të ardhura të tjera	320	341	364
Të ardhura nga garanci financiare	0	0	0

Të ardhurat nga burimet e veta vendore sipas Njësive Administrative

Pesha kryesore në realizimin e të ardhurave i ngarkohet Njesisë administrative Shkodër në vlerën 567,262 mijë Lekë, ose 69% të planit total të të ardhurave.

Planifikimi i të ardhurave për vitet 2020-2022 sipas Njësive Administrative / mijë Lekë																		
Viti	Totali	Njësia Administrative Qendër						Njësi Administrative të tjera										
		Shuma	Lagje nr. 1	Lagje nr. 2	Lagje nr. 3	Lagje nr. 4	Lagje nr. 5	Shuma	Pult	Shosh	Shalë	Postribë	Guri i Zi	Bërdicë	Velipojë	Dajç	Ana e Malit	Rrethina
Plan 2020	817,379	567,262	134,371	118,340	112,071	122,524	79,956	250,117	2,534	3,351	3,923	15,612	20,271	22,396	107,975	19,944	12,833	41,278
Plan 2021	822,317	570,690	135,184	119,055	112,748	123,264	80,439	251,627	2,549	3,371	3,947	15,707	20,393	22,531	108,627	20,064	12,911	41,527
Plan 2022	837,657	581,336	137,706	121,276	114,851	125,563	81,940	256,321	2,597	3,434	4,021	16,000	20,773	22,951	110,653	20,438	13,152	42,302

Shpërndarja e të ardhurave sipas Njësive Administrative



4.2.2 Të ardhurat nga Taksat Vendore


Ligji nr 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", me ndryshimet përkatëse, përbën ligjin bazë i cili përcakton rregullat për ushtrimin e të drejtave dhe detyrave të njësive të qeverisjes vendore në drejtim të taksave vendore, mbledhjes dhe administrimit të tyre.

Për vitet 2020-2022 parashikohet që të ardhurat nga taksat vendore përbëjnë rreth 49% të të ardhurave nga burimet e veta të bashkisë.

LLOJET E TË ARDHURAVE në 000/Lekë	Plan 2020	Plan 2021	Plan 2022
TË ARDHURA NGA TAKSAT VENDORE	397,063	399,818	402,585
Të ardhura nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël	7,500	7,650	7,800
Të ardhura nga taksa mbi Biznesin e vogel (e prapambetur)	50	50	50
Te ardhura nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme	171,666	173,783	175,910
Të ardhura nga taksa e fjetjes në hotel	17,000	17,340	17,680
Të ardhura nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	185,000	185,000	185,000
Të ardhura nga taksa e tabelës	15,847	15,995	16,145

Pjesë e rëndësishme në këtë kategori të taksave vendore janë të ardhurat nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme, e cila zë mbi 43% te totalit të të ardhurave nga taksat vendore, dhe më pas vijnë të ardhurat nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja me 47%, taksa e tabelës dhe taksa e fjetjes në hotel me 4%.

Të ardhura nga taksat vendore



Të ardhura nga Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël

Tatimi i thjeshtuar për biznesin e vogël administrohet nga Drejtoria Rajonale Tatimore, e cila në rolin e agjentit tatimor mban një komision prej 1% të vlerës së grumbulluar nga bizneset e vogla, ndërsa 99% kalon në favor të bashkisë Shkodër.

Të ardhura nga Taksa mbi pasurinë e paluajtshme

Këto të ardhura përfshijnë te ardhurat nga :

- Taksa mbi ndërtesat (mbi ndërtesa banimi dhe ndërtesa biznesi)
- Taksa mbi tokën bujqësore
- Taksa mbi truallin

Parashikimi për vitet 2020-2022 bazohet te zgjerimi i bazës së taksapaguesve nëpërmjet:

- Saktësimi dhe vlerësimi të drejtë të sipërfaqeve nëpërmjet grupeve të punës të ngritura për këtë qëllim,
- Mbështetja nga agjentë tatimorë,
- Ndarjes në këste të pagesave për familjarët,
- Shtrirje e mëtejshme e bazës taksapaguese, falë politikave fiskale lehtësuese dhe incentivave të ndërmarra, rivlerësimi të gjendjes faktike, përmirësimi të shërbimit dhe marrëdhënies me taksapaguesin, si dhe bashkëpunimi të pritsëm me institucionin Agjencia e Kadastrës Shtetërore, që përfshin ish-ZRRPP dhe ish- ALUIZNI-n.

Të ardhura nga Taksa e fjetjes në hotel

Planifikimi i të ardhurave me një rritje prej 2% në vit është bërë ju referuar kapacitetit aktual dhe parashikimit të zgjerimit të tij, rritjes së numrit të njësive, si dhe shtrirjen periudhave të sezoneve turistike për ushtrimin e aktivitetit.

Të ardhura nga Taksa e ndikimit në infrastrukturë

Bashkia Shkoder, planin e të ardhuravengataksa e ndikimit në infrastrukturë e kabazuar:

- Bazuar në ligjin 9632, taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja është përlogaritur duke marrë për bazë parashikimin e lejeve për ndërtime të reja në përputhje me Planin e Përgjithshëm Vendor, miratuar me vendimin e KKT nr.5 date 16.10.2017 “ Per miratimin e planit te pergjithshem vendor si dhe në nismat Publike për hartim e PDV-ve, sipas Planit të Përgjithshëm Vendor, në disa njësi strukturore.

Kjonëmbështetjeteligit nr.107/2014 datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, VKM nr. 686 datë 22.11.2017 “Për Miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Shkodër, miratuar me vendim të KKT Nr.5, datë 16.10.2017, si dhe në interesin public;

- Shlyerjen e detyrimeve për taksën e ndikimit në infrastrukturë të objekteve të legalizuara për objektet në process legalizimi, si dhe detyrime tatimore të pambledhura në kohë, prej më pak se 18 muaj nga afati i caktuar në legjislacionin në fuqi për pagesën e taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me ligjin. nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Realizimi i ardhurave nga kjo taksë lidhet dhe bazohet në zbatimin e masave shtrënguese, bllokimin e shërbimit të debitorëve nga bashkia Shkodër, si dhe në mbështetjen nga Agjencia e Kadastrës Shtetërore.

Të ardhura nga Taksa e Tabelës

Parashikimi në rritje prej 1% i të ardhurave bazohet në rritjen e njësive takapaguese e në evidentimin e kapaciteteve të reja, si dhe në shtrirjen e mëtejshme të bazës taksapaguese dhe kërkesën në rritje për vendosje tabela reklamimi në akse kryesore rrugore.

i. Të ardhurat nga Taksat e Ndara

LLOJET E TË ARDHURAVE në 000/Lekë	Plan 2020	Plan 2021	Plan 2022
TË ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA	89,735	92,439	95,144
Të ardhura nga taksa vjetore per qarkullimin e mjeteve të përdorura	70,000	72,100	74,200
Të ardhura nga taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme	14,000	14,560	15,120
Të ardhura nga taksa e rentës minerare	35	35	35
Të ardhura nga tatimi mbi te ardhurat personale	5,700	5,744	5,789

Të ardhura nga Taksa e regjistrimit të mjeteve të përdorura

Planifikimi i të ardhurave bëhet referuar numrit të automjeteve si dhe bazuar në eksperiencën e viteve të kaluara rereferuar të dhënave për nivelet e arkëtimeve nga Drejtoria e Përgjithshme e Transportit Rrugor .

Të ardhura nga taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme

Planifikimi bëhet nga te dhenat e agentit tatimor si dhe bazuar në eksperiencën e viteve të kaluara referuar numrit të procedurave të tjetërsimit të pronës të kryera nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës ish-Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Të ardhura nga Taksa e Rentës mine rare

Planifikimi i të ardhurave i referohet realizimit të të ardhurave ndër vite.

Të ardhura nga tatimi mbi të ardhurat personale

Planifikimi i të ardhurave i është referuar të dhënave statistikore për të punësuarit në territorin e bashkisë Shkodër, si dhe raporteve vjetore të Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër, të publikuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Megjithëse kjo taksë e ndarë është në fuqi që nga 1 Janar 2018, deri sot, NJQV-të nuk kanë përfituar asnjë të ardhur.

ii. Te ardhurat nga Tarifat Vendore

Referuar ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 35/5, bashkitë krijojnë të ardhura nga tarifatat vendore për: shërbimet publike që ato ofrojnë; dhënien e licencave, të lejeve, autorizimeve dhe për lëshimin e dokumenteve të tjera, për të cilat ato kanë autoritet të plotë, me përjashtim të rasteve kur përcaktohet ndryshe me ligj. Gjithashtu bashkitë mund të krijojnë të ardhura nga veprimtaritë e tyre kulturore, sportive, dhe të tjera, të përcaktuara me ligj.


Bashkitë vendosin vetë për nivelin, mënyrën e mbledhjes dhe të administrimit të tarifave vendore, në përputhje me politikat dhe parimet e përgjithshme kombëtare të përcaktuara në ligjet në fuqi.

Për vitin 2020-2022 të ardhurat e parashikuara nga tarifat përbëjnë rreth 38% të të ardhurave të veta.

LLOJET E TË ARDHURAVE në 000/Lekë	Plan 2020	Plan 2021	Plan 2022
TE ARDHURA NGA TARIFAT VENDORE	312,635	315,187	324,817
Te ardhura nga tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave	167,867	168,879	169,935
Të ardhura nga tarifa për ndriçimin publik	39,443	43,399	48,339
Të ardhura nga tarifa për gjelbrimin	21,648	21,796	21,957
Të ardhura nga tarifa të shërbimit administrativ të bashkisë	83,677	81,113	84,586

Peshën më të madhe në kategorinë e të ardhurave nga tarifat vendore e zënë të ardhurat nga tarifat për ofrimin e shërbimeve publike të pastrimit e largimit të mbeturinave me 54% të totalit të tarifave, duke qenë edhe një nga aktivitetet kryesore në funksionin e shërbimeve publike, të gjelbrimit me 7%, të ndriçimit publik me 13%, të shërbimit administrativ të bashkisë me 27%, ku bëjnë pjesë tarifat për zënien e hapësirës publike, tarifat e institucioneve të arsimit, kultures, sportit, etj

Raporti i tarifave vendore mbi totalin e tyre



Të ardhura nga tarifa e pastrimit, ndriçimit dhe gjelbërimit.

Parashikimi në rritje prej 1% i të ardhurave nga tarifat për pastrimin, ndriçimin dhe gjelbërimit, bazohet tek kapaciteti aktual dhe në rritjen e njësisve takapaguese e në evidentimin e kapaciteteve të reja, si dhe në shtrirjen e mëtejshme të bazës taksapaguese falë politikave fiskale lehtësuese, përmirësimit të shërbimit dhe marrëdhënies me taksapaguesin, fokusimit në zona me kapacitete të pashfrytëzuara, si dhe sensibilizimin dhe trajtimin e biznesit si partner në dhënien e shërbimeve për komunitetin.

Të ardhura nga tarifa për shërbimet administrative

Nga tarifa për shërbimet administrative që bashkia ofron si ato të drejtorisë të zhvillimit të territorit për aplikimet për leje, kontrole dhe verifikime, për aplikimet për AMTP-të etj si efekt i

rritjes së aplikimeve nga qytetarët, planfikohet rritje prej 3% të ardhura në vit, referuar trendit të rritur të kërkesave.

Të ardhura nga Tarifa për vulosje veterinare të bagëtive të therura

Tarifa është një detyrim fiks i cili aplikohet nga shërbimi veterinar për subjektet me aktivitet thertore, i bazuar në ligjin nr.10465, datë 29.09.2011 "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", i ndyshuar.

Bazuar në Urdhërat e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural me nr. 189, datë 04.05.2018 "Për miratimin e çertifikatës shëndetësore veterinare për mishin e kafshëve të llojit gjedh, të imta,derra, të therura në thertore",si dhe nr. 190,datë 04.05.2018 "Për miratimin e çertifikatës shëndetësore veterinare që shoqëron lëvizjen dhe transportin e ngarkesave me lëkurë dhe produkte me origjinë shtazore jo për konsum njerëzor", ku janë të miratuara modelet e çertifikatave shëndetësore veterinare për mishin e kafshëve të llojit gjedh, të imta,derra, të therura në thertore si dhe modelin e çertifikatës shëndetësore veterinare që shoqëron lëvizjen dhe transportin e ngarkesave me lëkurë dhe produkte me origjinë shtazore jo për konsum njerëzor, ngarkohet njësia e qeverisjes vendore për prodhimin e këtyre çertifikatave , të cilat shoqërohen dhe me kosto financiare.

Tarifa për vulosje mishi vendoset gjatë kryerjes nga ana e punonjësve të zyrës së veterinarisë të procesit të kontrollit të mishit të sapotherur, me efekt çertifikimit ose jo të tij. Rritja e propozuar parashikohet të indeksojë koston e këtij shërbimi veterinar.

Të ardhura nga Tarifat e licënsimit të veprimtarive të transportit

Plani i të ardhurave të parashikuara me rritje 5% në vit bazohet në trendin e aplikimeve për rinovimin e licencave për ushtrimin e veprimtarisë së subjekteve që pajisen me licënsën dhe çertifikatën përkatëse për transport udhëtarësh ose mallrash, për vete ose përtëretë.

Të ardhura nga Tarifa e parkimit për mjetet e licënuara dhe për vendparkime publike

Të ardhurat e planifikuara nga tarifa e parkingut për mjetet që janë pajisur me një licënsë transporti, dhe një pjesë e tyre kanë vende të caktuara me sinjalistikë të veçante rrugore si taksi, mikrobuzë, autobusë etj., ku parashikohet një rritje prej 9% të kërkesave.

Të ardhura nga Tarifa për dhënie licënsë për tregtimin të naftës bruto e n/produkteve

Bazuar në VKM Nr. 970, dt 02.12.2015 "Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënie licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj", ky zë parashikon rritje, duke u bazuar tek trendin e aplikimeve për rinovimin e licencave për ushtrimin e veprimtarisë së subjekteve që tregtojnë karburant, të cilave u përfundon afati 5- vjeçar i licencës.

Të ardhura nga Tarifat e sektorit të pyjeve dhe kullotave

Të ardhurat e parashikuara bazohen në trendin e aplikimeve të shërbimeve administrative që kryen sektori i pyjeve dhe kullotave.

Të ardhura nga Tarifat e shërbimeve të mbrojtjes nga zjarri

Të ardhurat e parashikuara me rritje 3% bazohen në nivelin e tarifave të shërbimeve që kryen struktura të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit ndaj shtetasve dhe personave, juridik e fizik, vendas e të huaj, si dhe në realizimin e të ardhurave vitet e kaluara nga kjo strukturë.

Të ardhura nga Tarifa për zënie e hapësirave publike

Parashikimi i të ardhurave me mesatarisht 2% është bërë duke ju referuar kërkesës në vite dhe trendit në rritje për shfrytëzimin e hapësirave publike brenda juridiksionit të Bashkisë.

Të ardhura nga Tarifat për linjat ajrore dhe nëntokësore (Telefoni, Energji, TV Kabllor, Internet)

Parashikimi i të ardhurave është bërë duke ju referuar kapaciteteve të hapësirave brenda juridiksionit të Bashkisë. Bashkia Shkoder është duke bërë regjistrimin e infrastrukturës pasive e cila mundëson vendosjen e rrjeteve të komunikimeve elektronike, ne regjistrin elektronik të të dhënave në sistemin ATLAS. Ne zbatim të Ligjit nr.120/2016 “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit”, Vendimit nr.851 datë 07.12.2016 “Për kalimin e të dhënave mbi shtrirjen e rrjetit të infrastrukturës inxhinierike të Bashkitë”, Ligji Nr. 9918 datë, 19.05.2008 Për Komunikimet Elektronike Në Republikën e Shqipërisë si edhe të Rregullores Nr. 26 datë 16.08.2012 “Për Përmbajtjen, formën dhe funksionimin e regjistrit elektronik të rrjeteve publike të komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë, BASHKIA konsiderohet si operator rrjeti, pasi ka në pronësi apo administron infrastrukturë pasive të tubacioneve, të cilat mundësojnë vendosjen e rrjetit të komunikimeve elektronike.

Të ardhura nga tarifat për veprimtaritë në institucione të arsimit, kulturës, sportit, shërbimit social etj.

Parashikimi i të ardhurave është bërë duke ju referuar kapaciteteve të këtyre institucioneve, si dhe realizimit ndër vite, me një rritje mesatarisht prej 0.5%.


iii. Të ardhura të tjera

LLOJET E TË ARDHURAVE në 000/Lekë	Plan 2020	Plan 2021	Plan 2022
TË ARDHURA TË TJERA	17,946	14,873	15,111
Të ardhura nga kundravajtjet administrative (Gjobat)	7,345	7,524	7,708
Të ardhura nga dhënia me qira e aseteve në pronësi të Bashkisë	3,190	3,190	3,190
Të ardhura nga sekuestrime dhe zhdëmtime	3,030	3,060	3,091
Grante nga ndihma nderkombetare	4,061	758	758
Të ardhura nga shitja e mallrave dhe e shërbimeve	0	0	0
Shitja e aseteve fikse të prekshme / paprekshme	0	0	0
Të ardhura nga privatizimi	0	0	0
Të ardhura të tjera	320	341	364
Të ardhura nga garanci financiare	0	0	0

Të ardhurat e tjera zënë 2% të totalit të të ardhurave të veta të Bashkisë Shkodër.

Peshën më të madhe në kategorinë e të ardhurave të tjera e zënë të ardhurat nga kundravajtjet administrative (Gjobat) me 41 % të totalit të të ardhurave të tjera, duke vijuar me Të ardhura nga dhënia me qira e aseteve në pronësi të Bashkisë dhe donacionet me 18%, Të ardhura nga

sekuestrime dhe zhdëmtime me 17%, Grante nga ndihma nderkombetare dhe donacione 23%, të ardhura te tjera 2%.



Te ardhurat nga kundravajtje administrative/gjobat

Gjobat bazohen në ligjin Nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”:

Bazuar në Nenin 6.b, ”Shkeljet që përbëjnë kundërvajtje administrative parashikohen me akte të këshillit bashkiak, për shkelje që nuk janë parashikuar si të tilla në ligje të veçanta, që kanë lidhje me fushat e veprimtarisë së tyre në njësitë territoriale përkatëse, ku, sipas ligjit, ushtrojnë funksionet e veta”.

Bazuar në Nenin 10, “Masa e dënimit me gjobë përcaktohet nga ligji, i cili ka parashikuar kundërvajtjen administrative.Masa e dënimit me gjobë mund të jetë fikse apo e përcaktuar me kufij minimalë dhe maksimalë.Në rastet kur kundërvajtjet administrative parashikohen në aktet e miratuara nga këshilli bashkiak, masa e dënimit përcaktohet në këto akte.

Ky zë parashikon të ardhurat nga kamatvonesa për mosshlyerje detyrimi në afate ligjore nga bizneset, gjoba nga kontrole dhe inspektime tatimore, gjoba për kundravajtje administrative që mund të vendosen nga Policia Bashkiake, nga Inspektoriati Ndërtimit Vendor etj.

Parashikimi i të ardhurave me me rritje 2.4% në vit është bërë duke ju referuar trendit të të ardhurave ndër vite kryesisht nga kamatvonesat për shlyerje pas afatit të detyrimit tatimor të bizneseve, nga gjobat e Policisë Bashkiake dhe nga gjobat e vendosura nga Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit.

Të ardhura nga dhënia me qira e aseteve në pronësi të Bashkisë

Parashikimi i të ardhurave është bërë duke ju referuar kontratave vijuese dhe kapaciteteve brenda juridiksionit të Bashkisë dhe dhënies me qera të objekteve të cilave i ka përfunduar ose i përfundon afati i kontratës, sipas miratimeve me vendim të këshillit bashkiak.

Te ky zë parashikohen të ardhurat nga qira të bazuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 529, datë 8.6.2011 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me

qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar. Pasuritë që jepen me qira janë ndërtesat, trualli i lirë, trualli i lirë funksional (jo nën ndërtesë), makineritë e pajisjet dhe linjat e prodhimit.

Të ardhura nga shitja e mallrave dhe shërbimeve

Sipas përcaktimeve ligjore, aktivet që pas vlerësimit nxirren jashtë përdorimit, kur mund të përdoren si vjetërsira/mbeturina/materiale të riciklueshme, hiqen nga rregjistri i aktiveve në përdorim, bëhen hyrje në magazinë dhe u shiten me ankand ndërmarrjeve që i grumbullojnë. Për zërin të ardhura ng ashitja e mallrave dhe shërbimeve nuk janë parashikuar të ardhura.

Të ardhura nga donacionet dhe grantet ndërkombëtare

Planifikimi i të ardhurave bazohet mbi marreveshjet për sponsorizime, donacione, dhe marrëveshje për grante ndërkombëtare sipas aplikimeve në thirrje të ndryshme .

Fondet e parashikuara janë për vitin 2020 në shumën lekë 4,061 mijëlekë.

4.3 Shpenzimet

Shpenzimet ne vitet 2017-2022 ne pjesen me te madhe mbulohen nga transferta te kushtezuar , transferte specifike dhe tarifa me destinacion mesatarisht 64.3% ndersa me transferte te pakushtezuar dhe te ardhura te tjera mbulohen vetem 35.7%. Konkretisht ne vitin 2020 mbulohen me transferte te pakushtezuar dhe te ardhurat e veta 31.7% dhe 68.3% me transferta te kushtezuar , transferte specifike dhe tarifa me destinacion , ne vitin 2021 mbulohen me transferte te pakushtezuar dhe te ardhurat e veta ne masen 35.4% dhe 64.6% me transferta te kushtezuar , transferte specifike dhe tarifa me destinacion ,ne vitin 2022 mbulohen me transferte te pakushtezuar dhe te ardhurat e veta ne masen 36% dhe 64% me transferta te kushtezuar , transferte specifike dhe tarifa me destinacion.

Ne vitin 2021 shpenzimet e pergjitheshme jane 2 917 971 dhe kane rnie me 1.7% ne raport me vitin 2020 qe është 2 969 318 , ne vitin 2022 jane rritur 3.4% ne raport me vitin 2021 dhe jane ne vlere 3 017 947 mijë lekë .

Shpenzimet per paga ne vitin 2021 kane rritje me 0.8% ne raport me vitin 2020 , ne vitin 2022 kane ulje 0.5% ne raport me vitin 2021 .

Shpenzimet korente ne vitin 2021 kane ulje me 0.2% ne raport me 2020 ndersa ne vitin 2022 kane ulje 1.1% ne raport me 2021.

Shpenzimet kapitale ne vitin 2021 kane rnie me 0.3% ne raport me 2020 ndersa ne vitin 2022 kane rritje 10.9% ne raport me 2022.

Ne **vitin 2020** jane planifikuar shpenzime bruto ne shumen 2 937 669 mijë lekë (pa perfshire fondin reserve dhe kontigjences) ku peshen me te madhe specifike sipas programeve e ze Nenfunkcioni 104 Familja dhe femijet me 34% , Nenfunkcioni 045 Transporti me 11.9 % , Nenfunkcioni 011 Organet ekzekutive dhe legjislative, çështjet financiare, fiskale, dhe çështjet e brendshme me 10.3% .

Paga dhe sigurime shoqerore zene 24% ndaj totalit dhe peshen me te madhe specifike 32.4 % e ze Nenfunkcioni 011 Organet ekzekutive dhe legjislative, çështjet financiare, fiskale, dhe çështjet e brendshme , 29.8% e ze Nenfunkcioni 091 me Arsimi baze dhe parashkollor, dhe 6.7% e ze Nenfunkcioni 092 Arsimi i mesem .

Shpenzimet korente zene 85.5 % ndaj totalit dhe peshen me te madhe specifike e ze Nenfunkzioni 104 Familja dhe femijet me 55.7%, Nenfunkzioni 051 Menaxhimi i mbetjeve me 11.4% dhe Nenfunkzioni 081 Sherbimet clodhese dhe sportive me 5.1%.

Shpenzimet kapitale zene 14.5% ndaj totalit dhe peshen me te madhe specifike me 71 % e ze Nenfunkzioni 045 Transporti, 10% e ze Nenfunkzioni 106 Strehimi dhe 4.3% e ze Nenfunkzioni 092 Arsimi i mesem

Ne **vitin 2021** jane planifikuar shpenzime bruto ne shumen 2 895 268 mijë lekë(pa perfshire fondin e kontigjnces) ku peshen me te madhe specifike sipas programeve e ze Nenfunkzioni 104 Familja dhe femijet me 35.5% , Nenfunkzioni 045 Transporti me 12.3 % dhe Nenfunkzioni 091 me Arsimi baze dhe parashkollor me 10.4%.

Paga dhe sigurime shoqerore zene 25% ndaj totalit dhe peshen me te madhe specifike 33.2 % e ze Nenfunkzioni 011 Organet ekzekutive dhe legjislative, çështjet financiare, fiskale, dhe çështjet e brendshme , 29.7% e ze Nenfunkzioni 091 me Arsimi baze dhe parashkollor, dhe 6.6% e ze Nenfunkzioni 092 Arsimi i mesem .

Shpenzimet korente zene 85.3 % ndaj totalit dhe peshen me te madhe specifike e ze Nenfunkzioni 104 Familja dhe femijet me 56.6%, Nenfunkzioni Menaxhimi i mbetjeve me 11.3% dhe Nenfunkzioni 081 Sherbimet clodhese dhe sportive me 4.6%.

Shpenzimet kapitale zene 14.7% ndaj totalit dhe peshen me te madhe specifike me 74 % e ze Nenfunkzioni 045 Transporti, 5.5% e ze Nenfunkzioni 091 me Arsimi baze dhe parashkollor dhe 4.6% e ze Nenfunkzioni 041 Çështje të përgjithshme ekonomike, tregtare dhe të punës.

Ne **vitin 2022** jane planifikuar shpenzime bruto ne shumen 2 995 985 mijë lekë (pa perfshire fondin e kontigjnces) ku peshen me te madhe specifike sipas programeve e ze Nenfunkzioni 104 Familja dhe femijet me 34.9% , Nenfunkzioni 045 Transporti me 12.3 % dhe Nenfunkzioni 091 me Arsimi baze dhe parashkollor me 10.5%.

Paga dhe sigurime shoqerore zene 24.5% ndaj totalit dhe peshen me te madhe specifike 32.5 % e ze Nenfunkzioni 011 Organet ekzekutive dhe legjislative, çështjet financiare, fiskale, dhe çështjet e brendshme , 29.7% e ze Nenfunkzioni 091 me Arsimi baze dhe parashkollor, dhe 7% e ze Nenfunkzioni 092 Arsimi i mesem .

Shpenzimet korente zene 84.2 % ndaj totalit dhe peshen me te madhe specifike e ze Nenfunkzioni 104 Familja dhe femijet me 56.3%, Nenfunkzioni Menaxhimi i mbetjeve me 11.1% dhe Nenfunkzioni 064 Ndricimi rrugor me 4.8%.

Shpenzimet kapitale zene 15.9% ndaj totalit dhe peshen me te madhe specifike me 68.9 % e ze Nenfunkzioni 045 Transporti, 7.2% e ze Nenfunkzioni 092 Arsimi i mesem dhe 6.4% e ze Nenfunkzioni 091 me Arsimi baze dhe parashkollor.

Ne shpenzimet bruto nukështë perfshire fondi kontigjence i planifikuar per 2020-2022 (kjo referuar FPT). Ne vitin 2020 është planifikuar shuma 31 649 mijë lekë, ne vitin 2021 është planifikuar shuma 22 703 mijë lekë dhe ne vitin 2022 është planifikuar shuma 21 962 mijë leke. Komente referuar tabelës F6 dhe F7 te FPT.

4.4 Rezultati total i buxhetit

Në mijë Lekë

(F13) STATISTIKA FINANCIARE TË PËRGJITHSHME						
	2017	2018	2019	2020	2021	2022
TOTALI I BURIMEVE TË BUXHETIT						
Burimet e përgjithshme të buxhetit	3,061,064	3,015,862	3,669,705	2,969,318	2,917,971	3,017,947
TOTALI I SHPENZIMEVE						
Shpenzimet e përgjithshme	2,402,695	2,610,086	3,595,485	2,937,669	2,895,268	2,995,985
TOTALI I FONDEVE REZERVE + KONTIGJENCË						
TOTALI I FONDEVE REZERVE + KONTIGJENCË				31,649	22,703	21,962

4.5 Informacion financiar suplementar

4.5.1 Huamarrje 6

Bashkia Shkoder nuk ka huamarrje
Tabela F1, seksioni C për huatë e reja, financimin me kredi është zero.

4.5.2 Detyrime të prapambetura

Sipas përcaktimit në Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, detyrime të prapambetura konsiderohen detyrimet financiare të përcaktuara nga një ligj/kontratë /marrëveshje /vendim gjykate i formës së prerë që mbeten të papaguara 60 ditë pas datës së specifikuar në kontratë apo me ligj, duke përfshirë edhe periudhën kontraktuale të shtyrjes së pagesës, të cilat kanë lindur në njësitë e vetëqeverisjes vendore (kontratat e financuara nga qeveria qendrore).

Në zbatim të Ligjit nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, neni 40, germa “h”, detyrimet e Bashkisë Shkodër janë krijuar në vite, si rrjedhojë e keqmenaxhimit të financave nga ish Komunat (Njësitë Administrative), kjo në zbatim të reformës territoriale VKM nr 510, datë 10.06.2015 “ Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrative-territorial”, si dhe parashikimit optimist të të ardhurave.

Me vendim të Këshillit Bashkiak nr. 15 Dt. 28.04.2016 “Per miratimin e buxhetit faktitk te vitit 2015 te Bashkise Shkoder”, Bashkia Shkoder, ka trashëguar nga ish-komunat detyrime per vendime gjykate te formes se prere ose ne proces, detyrime me fatura, detyrime pa fatura dhe vetem me kontrata.

Gjate vitit 2019, Bashkia Shkoder, ka raportuar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr.5645 prot, datë 08.04.2019, për tremujorin e parë të vitit 2019 dhe me shkresë nr.11359 prot, datë 01.07.2019 për tremujorin e dytë të vitit 2019, dhe me shkresë nr.16578 prot, datë 02.10.2019 për tremujorin e tretë të vitit 2019.

Në detyrimet e prapambetura peshën më të madhe e zënë Investimet prej rreth 21 milion lekë, kryesisht me parregullsi ligjore dhe financiare, të pamundura të likuidohen , si dhe shpenzimet gjyqësore prej rreth 29 milion lekë, në proces gjykimi dhe shpresojmë që këto procese të hapura të jenë në favor të Bashkisë Shkodër.

Me datë 19.03.2019 me nr.4337 prot është bërë shkresë MFE me objekt “ Informacion mbi kalendarin e planit të veprimit për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura për bashkinë Shkodër për vitet 2019-2022”.

4.5.3 Treguesit financiarë

Referuar tabelës F14 të FPT sqarojmë se norma totale e shpenzimeve ndaj totalit të të ardhurave për vitet 2017 është 78.5% si rrjedhojë e gjendjes së trashëguar në fund të vitit 2017 ndërsa në vitin 2018 është 86.5% .Ndërsa në vitin 2019 kemi planin e pritsëm të vitit 2019 dhe deri në këtë moment planifikojmë që do realizohen të ardhurat e planifikuara, ndërsa është gjendje 74,220 mijë lekë fonde të trashëguara me destinacion, fond rezerve dhe renta minerare . Ndërsa për vitet 2020-2022 është 100% .

Raporti i të ardhurave nga burimet e veta në raport me të ardhurat e përgjithshme varion nga me e ulet 19.1 % në vitin 2019 në raportin me të lartë në 28.2% në vitin 2021.

Kemi rritje të shpenzimeve kapitale ndaj totalit të shpenzimeve nga vitin në vitin 2022 dhe konkretisht nga 15% në vitin 2020 në 14.9% në vitin 2021 dhe 15.9% në vitin 2022.

Shpenzimet korrente ku përfshihen shpenzimet e personelit, shpenzimet operative, subvencione dhe të gjitha llojet e transferimeve janë në zbritje nga viti 2021 në vitin 2022 dhe konkretisht nga 85.1% në 84.1% .

Shpenzimet e personelit ndaj totalit të shpenzimeve variojnë nga 24.3 % në vitin 2020 në 25% në vitin 2021 dhe pastaj kemi rënie në vitin 2022 me 24.3% .

Norma e shpenzimeve për politikën sociale për vitet 2020-2022 varion nga 27.1% në vitin 2019 në 37.2% në vitin 2020, kjo sepse në planin e pritsëm të vitit 2019 kemi të pasqyruar planin e akorduar për pagesën e ndihmës ekonomike dhe paaftësisë vetëm për 10 muaj. Kjo sepse ky fond akordohet nga qeveria çdo 2 muaj dhe jo vjetor. Në vitin 2021 kemi raportin e normës së shpenzimeve në politikën sociale 36.5% ndërsa në vitin 2022 e kemi 36% .

Referuar Tabelës F14 Treguesit financiarë

4.5.4 Rreziqet financiare dhe fiskale

